

Fjalorthi i historisë nga FGJSSH (1980)

Mr. Agim Spahiu

16 mars 2009

Përmbledhje

Ky Fjalorth është nxjerrë në mënyrë elektronike (automatizisht), me anë të programeve: *grep, sort, uniq, awk* etj., duke u mbështetur në **Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe** të vitit 1980.

AGA m.

2. Titull për oficerë në ushtrinë e vjetër turke; ai që mbante këtë titull. Agai i jeniçerëve.

AJAR m. vjet. Bënin ajar drithin matnin me ajar; ndanin me masë prodhimin në pjesë për shtetin, për beun e për kishën si taksë në natyrë.

AKINXHI m. Kalorës ose këmbësor i trupave sulmuese e ndëshkimore në Perandorinë Osmane, që mbaheshin në kufi me vendet e tjera dhe që sulmonin të parët për të vrarë, për të djegur e për të plaçkitur. Ushtria e akinxhinjve. Komandanti i akinxhinjve.

AKREPTAR m. Ushtar që luftonte me një armë prej metali në formë gresi, në kohën e lashtë e në mesjetë.

AKTLIRIM m. Dokument që vërtetonte lirin e një skllavi ose të një bujkrobi, akt liri.

ALBANË m. vet. Një nga fiset kryesore ilire, që banonte në Shqipërinë e Mesme. Fisi i albanëve.

ALEBARDË f. Armë e vjetër, shtizë e gjatë me majë si heshtë dhe me një sëpatë të vogël në krye. Ushtarë me alebarda.

ALLAJBE m. Komandant i spahinjve të një krahine; komandant i xhandarmërisë në një vilajet (në kohën e fundit të sundimit osman në Shqipëri).

ANADOLLAK m. 1. Banor turk i Azisë së Vogël në periudhën e feudalizmit ushtarak osman; ushtar ose përfaqësues i pushtuesve osmanë.

ANADOLLAK mb. 1. Që ka të bëjë me Azinë e Vogël në periudhën e feudalizmit ushtarak osman; osman, turk. Pushtuesit anadollakë.

ANALE f. vet. 1. Vepër ku shënoheshin vit për vit ngjarjet më të rëndësishme të kohës. Shkruante analet.

ANDART m. 1. Pjesëmarrës në çetat e komitëve grekë, që ishin në shërbim të ushtrisë dhe të qeverisë shoviniste greke. Përleshjet me andartët.

ANGARI f. 1. Punë e detyruar pa shpërblim, që bënte fshatari për beun ose për shtetin me krahë dhe me mjetet e kafshët e veta të punës; punë e detyruar pa shpërblim. Angaritë për shtetin. Pesë ditë angari. Bënin angari.

ANTIZOGIST mb. 1. Që luftonte kundër regjimit antipopullor të Ahmet Zogut, që

- drejtohej kundër regjimit zogist. Lëvizje (demonstratë) antizogiste. Grup antizogist.
2. si em. ~, ~I m. ~Ë, ~ËT. Kundër-shtar i regjimit antipopullor të Ahmet Zogut.
- APOTEOZË** f. 1. Rit në Greqinë dhe në Romën e vjetër, me të cilin nderonin si perëndi një hero, një perandor etj.
- ARADHE** f. 1. Repart partizan më i madh se batalioni gjatë Luftës Nacionalçlirimtare; njësi e madhe ushtarake. Aradhe partizane. Komandant i aradhes.
- ARBËR** I m. 1. Emër përmbledhës për shqiptarët në mesjetë; arbëresh, shqiptar. Lufta e arbit. Pushka e arbit. Krerët e arbit.
- ARBËR** mb. poet. Që u përket shqiptarëve të mesjetës, i arbërve; shqiptar, arbëror. Fjalë arbëre. Toka arbëre.
- ARDIAN** m. kryes. Pjesëtar i njërit nga fiset kryesore ilire, që banonte në trojet midis Liqenit të Shkodrës dhe Dalmacisë. Shteti i ardianëve.
- ARDIAN** mb. Që lidhet me ardianët, i ardianëve; që është krijuar nga ardianët. Fis ardian. Shteti ardian.
- ARGATËRI** f. 1. përmb. Tërësia e argatëve, argatët; shtresa e argatëve.
2. Puna e argatit, punë me mëditje në bujqësi; të qenët argat, gjendja e argatit.
- ARGATI** f. shih ARGATËRI, ~A.
- ARIAN** m. kryes. 1. Emër i përbashkët për popujt e lashtë, që flisnin në gjuhët indoevropiane.
- ARIAN** mb. Që u përket arianëve, i arianëve. Grupi arian. Gjuhët ariane. Tipare ariane.
- ARISTOKRACI** f.
3. Formë qeverisjeje, në të cilën pushtetin e ka një grup i vogël fisnikësh me tituj të trashëgueshëm.
- ARKEBUZ** m. Pushkë e vjetër me fitil, që mbushej nga gryka.
- ARKOND** m. 1. Titull i lartë i magjistratëve, që qeverisnin qytetet-shtete në Greqinë e lashtë.
2. Titull në hierarkinë feudale, që e mbante një pronar i pasur nga paria e vendit. Arkondët feudale. Sillet si arkond sillet rëndë e me mospërfillje ndaj të tjerëve, mbahet me të madh.
- ARKONDESHË** f. E shoqja e arkondit.
- ARKONDI** f. Krahinë që sundohej dhe qeverisej nga një arkond; pronat, zotërimet e arkondit.
- ARMATURË** 7. Pajisja luftarake e një ushtari në kohët e vjetra e në mesjetë. Armaturë e lehtë (e rëndë). Armatura e luftëtarit. Heq (vë) armaturën.
- ARMËMBAJTËS** m. 1. Ai që shoqëronte një kalorës dhe që mbante armët në kohën e mesjetës, shqytar.
- ARMOR** m. Veshje mbrojtëse prej metali, që e përdorin luftëtarët në kohët e vjetra dhe në mesjetë. Armor i çeliktë. Mbaj (vesh) armorin.
- ARQIOMARKSIST** m. Anëtar i një organizate antimarksiste, të krijuar në Greqi me 1920, që shtrembëronte marksizëm-leninizmin e luftonte lëvizjen komuniste dhe që gjatë Luftës së Dytë Botërore bashkëpunoi me fashistët.
- ARQIOMARKSIST** mb. Që ka të bëjë me arqiomarksistët, që u përket arqiomarksistëve, i arqiomarksistëve. Pikëpamje arqiomarksiste. Grup arqiomarksist.
- AS** II m. Monedhë e vogël romake prej bakri. Okë e as fare lirë.
- ASAMBLIST** m. Anëtar i asamblesë kombëtare. U zgjodh asamblist.
- ASQERIE** f. Taksë që paguhej në kohën e pushtimit osman për të zëvendësuar shërbimin ushtarak. Paguanin asqerien. Mblidhnin asqerien.

- ASHAR** m. E dhjeta që paguhej si taksë. Paganin (jepnin) asharin. Mblidhte asharin.
- ATINTAN** m. kryes. Pjesëtar i njërit nga fiset kryesore ilire, që banonte midis Vjosës dhe Osunit.
- ATINTAN** mb. Që lidhet me atintanët, i atintanëve; që është krijuar nga atintanët. Fisi atintan. Luftëtar atintan.
- BAHETAR** m. Hobetar. Gjuanin bahetarët.
- BAJRAK** m.
2. Njësi ushtarake e më vonë administrative, që u krijua në ndarjen tokësore të disa krahinave të Shqipërisë ku kishte mbeturina të organizimit fisnor patriarkal dhe që i zuri vendin këtij organizimi. Ndarja në bajraqe. Krerët (përfaqësuesit) e bajraqeve.
- BAJRAKTAR** m.
2. Kreu i bajrakut, që përfaqësonte interesat e shtresës më të pasur e të privilegjuar dhe që drejtonte bajrakun në bazë të kanuneve patriarkale. Kullat e bajraktarit. Sillej si bajraktar.
- BAJRAKTARIZËM** m. 1. Formë e prapambetur patriarkale e organizimit ushtarak e tokësor, që mbështetej në ndarjen sipas bajraqeve; sundimi i bajraktarit. Mbeturina të bajraktarizmit. Përmbysja e bajraktarizmit.
- BALESTËR** f.
2. Arbaletë.
- BALLKANAS** mb. Ushtria ballkanase.
- BALLKANIK** mb. Lufta ballkanike. Konferenca ballkanike. Aleanca ballkanike.
- BARBAR** m. 1. kryes. Emër me të cilin grekët dhe romakët e vjetër quanin me përbuzje të huajt, që nuk flisnin gjuhën e tyre dhe që i mbanin si të pazhvilluar.
- BARBAR** mb. 1. Që ka të bëjë me popujt e tjerë, të cilët grekët e romakët e vjetër i mbanin si të pazhvilluar dhe i quanin me përbuzje me emrin «barbarë». Fiset barbare. Dyndjet barbare. Ushtritë barbare.
- BARBARI** f.
3. Periudha e dytë e zhvillimit të shoqërisë primitive pas egërsisë, shkalla para qytetërimit në zhvillimin historik të shoqërisë njerëzore. Periudha e barbarisë.
- BARON** m. Titull i pronarëve feudalë etj. në Evropën Perëndimore, i cili zinte vendin e pestë në hierarkinë e aristokracisë dhe ishte një shkallë më poshtë se ai i kontit; ai që mbante këtë titull.
- BARONESHË** f.
2. E shoqja ose e bija e baronit.
- BASHIBOZUK** m. 1. Ushtar i trupave ndihmëse të parregullta në Perandorinë Osmane. Ushtria e bashibozukëve.
- BASHKARI** f. shih BASHKËSI, ~A 3.
- BASHKËSI** f.
3. Formë e organizimit të shoqërisë në rendin e komunës primitive, kur njerëzit i zotëronin së bashku mjetet e prodhimit dhe vetëqeveriseshin; formë e tillë që u ajt pjesërisht edhe më vonë në shoqërinë me klasa; komunë. Bashkësia primitive. Bashkësi fisnore. Bashkësitë fshatare. Anëtarët e bashkësisë. Prona e bashkësisë. Shturja e bashkësisë.
- BASHTINAR** m. Pronar i një bashtine në sistemin e timareve.
- BASHTINË** f. 1. Copë toke e trashëgueshme, që e zotëronte një familje fshatare në sistemin e timareve dhe që e punonte si arë.
2. Kopsht, bahçe. Ara e bashtina.
- BAXHAXHI** m. Ai që mblidhte taksën bashkiake për shitjen e bagëtive e të sendeve të tjera në treg në kohën e sundimit osman dhe në vitet para Çlirimit.
- BAXHË** II f. Taksë bashkiake që paguhej në kohën e sundimit osman dhe në vitet para Çlirimit për shitjen e bagëtive e të sendeve të tjera në treg. Paganin baxhën. Merrej baxhë.

- BAZHDAR** m. Nëpunës që peshonte mallrat në treg dhe që merrte një taksë të caktuar për to. Taksa e bazhdarit. Kandar bazhdari.
- BAZHDARI** f. 1. Taksa që merrte bazhdari kur peshonte mallrat në treg. E drejta e bazhdarisë.
2. ~, ~TË. Vendi ku rrinte bazhdari për të peshuar dhe për të marrë taksën; puna e bazhdarit. I peshonin në bazhdari.
- BEDEL** m. 1. Ai që shkonte në vend të një tjetri në ushtri ose në punë të detyruar kundrejt një pagese. Bedel në ushtri. Dërgoi (vuri, pagoi) bedel. Shkoi (hyri) bedel. La bedel. Punoi bedel.
3. Taksë që paguhej në kohën e pushtimit turk nga meshkujt myslimanë për të zëvendësuar shërbimin ushtarak, asqerie; pagesë që jepej në vend të punës së detyrueshme. Bedeli i rrugës. Të hollat e bedelit. Paganin bedelin.
- BEJ** m. 1. Pronar tokash në sistemin ekonomik feudal në Shqipëri para Çlirimit, pjesëtar i klasës çifligare sunduese. Beu i fshatit. Tokat (kullat) e beut. Shpronësimi i bejlerëve. Lufta kundër bejlerëve.
2. Titull i vjetër turk për qeveritarin e një krahine dhe më pas titull fisnikërie më i ulët se i pashait.
- BEJLERESHË** f. E shoqja ose e bija e beut.
- BEJLLËK** m. 1. Të qenët bej; vendi që zinte beu dhe titulli i tij.
3. Taksë në natyrë ose në të holla, të cilën ia paguanin fshatarët derebeut, që t'u siguronte një farë mbrojtjeje. Jepnin bejllëk.
- BELEDIE** f. Bashki (në kohën e sundimit osman në Shqipëri).
- BERSALIER** m. Ushtar i trupave speciale të këmbësores italiane, të përgatitura për veprime të shpejta, që erdhën edhe në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore si trupa pushtuese. Pendë bersalierësh një tufë pendë gjeli që këta ushtarë e mbanin në kapelë.
- BIMBASH** m. Oficer epror në ushtrinë e Perandorisë Osmane, i cili kishte fije gradë që i përgjigjet asaj të majorit.
- BIZANTIN** m. Shtetas i Perandorisë mesjetare të Bizantit.
- BOMBARDË** f. Armë luftarake që përdorej në mesjetë për të hedhur gjyle guri ose predha metali; një lloj topi që përdorej në mesjetë. Predhë bombarde. Rrahu kështjellën me bombardat.
- BORGJEZOHEM** vetv. 1. kryes. veta III Kthehet në klasë ose në shtresë borgjeze, bëhet borgjez. Feudalët dalëngadalë u borgjezuan.
- BRESHANË** f. Pushkë me strall, me tytë të gjatë e me qoshe, që mbushej nga gryka.
- BRESHKORE** f. Mburojë e madhe në trajtën e kurrizit të breshkës, që përdorej në luftime.
- BRICORE** f. Armë brezi me strall.
- BRIGADË** f.
2. Njësi e Ushtrisë Nacionalçlirimtare që përbëhej zakonisht nga katër batalione. Brigada e Parë Sulmuese. Brigadat partizane. Komandanti (komisari) i brigadës. Flamuri (himni) i brigadës.
- BRIZAN** m. Ai që i binte bririt gjatë luftimeve (në mesjetë).
- BRONZ** m.
* Koha (periudha, epoka) e bronzit periudha historike midis mijëvjeçarit V e atij II para erës së re, kur u zbulua e u përdor bronzi. Sëmundja e bronzit mjek. sëmundje që u bie fletëve të agrumeve, të cilat marrin një ngjyrë si ajo e bronzit.
- BUJAR** m. Pronar i madh tokash, përfaqësues i shtresës më të lartë e të privilegjuar të klasës shfrytëzuese në shoqërinë feudale; fisnik.
- BUJAR** mb.
2. Që ka të bëjë me shtresën e bujarëve, që lidhet me aristokracinë feudale, i bujarëve. Familje bujare.

BUJARI f.

2. Shtresa më e lartë dhe e privilegjuar e klasës shfrytëzuese, shtresa e aristokracisë në shoqërinë feudale; tërësia e bujarëve, bujarët, fisnikëria; parësia, shtresa më e lartë në një fis. Bujaria feudale. Bujaria e lartë. Bujaria e fisit. Shtresa e bujarisë.

BUJK m.

2. Ai që merrte tokë me qira nga pronari, e punonte dhe mbante për vete vetëm një pjesë të vogël të prodhimeve; çifçi.

BUJKROB m. Fshatar në sistemin feudal, që ishte rob i feudalit a i çifligarit e shfrytëzohej prej tij, që nuk kishte asnjë të drejtë mbi tokën, mbi mjetet e punës, mbi prodhimet e asnjë të drejtë qytetare dhe që mund të shitej e të blihej si skllav së bashku me tokën; skllav i tokës. Puna e bujkrobërve.

BUJKROB mb. Që ishte bujkrob; që rronte në bujkrobëri. Fshatar bujkrob. Familje bujkrobo.

BUJKROBËRI f. Formë shfrytëzimi e varësie e bujkrobërve nga feudali a nga çifligari në rendin feudal; sistem shoqëror, që mbështetej në varësinë e bujkrobërve nga feudalët a nga çifligarët. Sistemi i bujkrobërisë. Zhdukja (heqja) e bujkrobërisë.

BUJKROBËROHEM vetv. 1. Bëhem bujkrob, kthehem në bujkrob.

BUJKROBËROJ kal. E bëj bujkrob, e kthej në bujkrob; e trajtoj si bujkrob.

BUJKROBËROR mb. Që ka të bëjë me bujkrobërinë, që i përket bujkrobërisë; që mbështetet në bujkrobërinë, që ka tiparet e veçoritë dalluese të bujkrobërisë. Sistem bujkrobëror. Marrëdhënie bujkrobërore.

BUJKROBËRUES mb. 1. Që ka të drejtën mbi tokën, mbi mjetet e punës e mbi prodhimet dhe që shfrytëzon punën e bujkrobërve; që jeton me djersën

e bujkrobërve. Feudal (çifligar) bujkrobërues.

3. si em. ~, ~I m. ~, ~IT. Feudal bujkrobërues. Pushteti i bujkrobëruesve. Përmbysja e bujkrobëruesve.

BYLYK m. 1. Njësi ushtarake në Perandorinë Osmane, që përbëhej nga njëqind deri dyqind e pesëdhjetë ushtarë me pagesë.

BYLYKBASH m. Komandant bylyku; oficer i ushtrisë osmane, i cili mbante rregullin publik.

CENS m. 1. Regjistrimi që i bëhej çdo pesë vjet pasurisë së qytetarëve në Romën e lashtë për t'i ndarë në kategori, sipas të cilave paguheshin taksat. Viti i censit. Bëhej censi.

CENSOR m. 1. Zyrtar i lartë në Romën e lashtë, që drejtonte regjistrimin e vlerësimin e pasurisë së qytetarëve për vjeljen e taksave dhe mbikëqyrte sjelljen e qytetarëve.

CENTURIE f. 1. Njësi prej njëqind ushtarësh kalorës në Romën e lashtë; qindëshe. Centuriet e kohortës.

2. Grup prej njëqind qytetarësh në Romën e lashtë, i krijuar në ndarjen e popullsisë sipas censit të pasurisë për qëllime politike e administrative; qindëshe.

CENTURION m. Komandant i një centurieje në ushtrinë e Romës së lashtë; komandant i qindështes, kryeqindës.

CITADELË f. 1. Kështjellë në vend të ngritur nga mund të vështrohej një qytet, që duhej mbrojtur; pjesë e përforcuar brenda mureve të një kështjellë, që shërbente si mbështetja e fundit gjatë sulmeve.

ÇAUSH m. 1. Nënoficer me gradën e rreshterit në ushtrinë e Perandorisë osmane. Çausht këmbësor (kalorës).

2. Ushtarak pranë një oficeri të lartë ose një komandanti për të kryer detyra të ndryshme. Çaushtët ngrinin çadrat.

3. Polic bashkie në Shqipëri para Çlirimit.

4. Kryepunëtor në punë botore para Çlirimit

ÇELNIKATË f. 1. Bashkimi i disa barinjve shtegtarë me një çelnik në krye për t'i kullotur tufat e tyre e për të punuar bulmetin bashkërisht.

ÇETË f. 1. Grup i vogël njerëzish të armatosur me një kryetar a komandant në krye, që kryejnë veprime të përbashkëta. Çetat e kreshnikëve. Çetë luftëtarësh. Çetat e lirisë. Çetat e maleve. Çetë kusarësh. Lufta e çetave. Luftëtarët e çetës. Dolën në çetë.

2. Njësi e vogël partizanësh me rreth pesëdhjetë veta, me një komandant dhe një komisar në krye, gjatë Luftës Nacionalçlirimtare. Çetë partizane. Çetë territoriale (vullnetare, e vendit) reparte vetëmbrojtjeje jo të rregullta, që kapnin armët për të luftuar së bashku me partizanët ose për t'i bërë ballë armikut në krahinat e çliruara. Çeta «Selam Musaj». Komisari (komandanti) i çetës. Aksionet e çetës. Formimi i çetës. U mbush mali me çeta.

ÇIFÇI m. Bujk pa tokë, që punonte një copë nga pronat e çifligarit dhe që mbante për vete vetëm një pjesë të prodhimit (në vendet me marrëdhënie feudale në prodhim; në të kaluarën edhe në Shqipëri). Familje çifçinjsh. Fshatarët çifçinj. Lufta e çifçinjve. Punonte tokën me çifçinj.

ÇIFLIG m. 1. Pronë tokë e trashëgueshme e feudalëve ose e çifligarëve, që punohet nga bujqit (në vendet me marrëdhënie feudale në prodhim; në të kaluarën edhe në Shqipëri). Çiflig i madh. Pronari i çifligut. Sistemi i çifligjeve. Të ardhurat nga çifligu. Shkatërrimi i çifligjeve. Vinin çifligje. I linin çifligjet trashëgim. I shpronësua çifligjet.

ÇIRAK I m. 1. Djalë që punonte si ndihmës te një zejtar për disa vjet pa shpërblim për të fituar mjeshtërinë. Çiraku i armëtarit (i këpucarit). Hynin çirakë. E futi çirak.

ÇLIRIM m.

2. Dita e 29 Nëntorit 1944, kur Shqipëria u çlirua nga pushtuesit fashiste dhe u vendos pushteti popullor. Dita e Çlirimit. Festa e Çlirimit. Para Çlirimit. Pas Çlirimit. Që nga Çlirimi e këtej.

ÇMESËTAR m. 1. Ai që çmonte dëmin e bërë, ai që caktonte vleftën që duhej paguar për një dëm të bërë. Çmesëtari i fshatit.

2. Ai që përcaktonte me afërsi prodhimin që do të jepte një arë e mbjellë, një pemë etj.; çmues.

DALMAT m. kryes. Pjesëtar i njërit prej fiseve ilire, që banonte në trojet e Dalmacisë. Dalmatët ishin fqinjë me ardianët.

DALMAT mb. Që ka të bëjë me dalmatët, që është krijuar nga dalmatët; që u përket dalmatëve, i dalmatëve. Fis dalmat. Fjalë dalmate.

DAMKË f. Damka e skllavërisë.

DARDAN m. kryes. Pjesëtar i njërit prej fiseve kryesore ilire, që jetonte në pjesën verilindore të trojeve të banuara sot nga shqiptarët. Fisi i dardanëve.

DARDAN mb. Që ka të bëjë me Dardaninë ose me dardanët, që është krijuar nga dardanët; që u përket dardanëve, i dardanëve. Popullsi dardane. Luftëtar dardan. Kështjellë dardane. Kulturë dardane. Legjendë dardane.

DASARET mb. Që ka të bëjë me dasaretët, që është krijuar nga dasaretët; që u përket dasaretëve, i dasaretëve. Luftëtar dasaret. Grua dasarete. Kultura dasarete.

DASH m.

3. Tra i madh me majë prej metali, që përdorej si mjet për të shpuar muret e kështjellave a për të shpërthyer portat e tyre. E goditnin portën me dash. I shembën muret me dash.

DEBATIKAS m. 1. Anëtar i organizatës antifashiste të fëmijëve me emrin

«Debatik» (Djemtë e Bashkuar Anëtarë të Idesë Komuniste), që vepronte gjatë Luftës Nacionalçlirimtare nën drejtimin e Rinisë Komuniste. Debatikas trim. Aksioni i debatikasve.

U bë debatikas.

DEFTER m.

2. Regjistër i kadastrës (gjatë pushtimit turk). Defteri i sanxhakut.

DEKAN m.

4. Komandant i dhjetë ushtarëve në ushtrinë romake.

DEMAGOG m.

2. Në Greqinë e lashtë: kryetari i një partie popullore; prijës i popullit, që i nxiste e i ndizte masat për të vepruar.

DEREBE m. Sundimtar feudal që kishte për detyrë të siguronte rrugët nëpër trevat malore dhe që më vonë u bë çifligar i pasur (gjatë sundimit osman).

DESPOT m. 1. Sundimtar me pushtet absolut e të pakufizuar (në monarkitë skllavopronare të Lindjes së Lashtë); sundimtar feudal, në një krahinë të caktuar, i cili varej nga mbreti a nga perandori dhe nuk qeveriste në bazë të ligjeve, por vepronte në mënyrë arbitrare pa përfillur fare dëshirat e vullnetin e popullit; titull i lartë në hierarkinë feudale; tiran.

DESPOTAT m. Shtet a krahinë që sundohej nga një despot. Despotati i Epirit.

DESPOTIZËM m. 1. Formë qeverisjeje që bazohej në sundimin e një monarku a të një njeriu të vetëm me pushtet të pakufizuar e absolut; tirani. Despotizmi lindor (oriental).

DIKTATOR m. 1. Kryetar i një shteti a i një qeverie, i cili ka pushtet të pakufizuar dhe vepron me egërsi e pa përfillur askënd. Diktator fashist. Diktator i egër.

2. Njeri, të cilit i jepej nga senati në Romën e Vjetër pushtet i pakufizuar (zakonisht për gjashtë muaj), kur shtetit i kanosej një rrezik i madh nga jashtë ose

kur duheshin shtypur kryengritjet popullore.

DIKTATURË f. 1. Pushtet i pakufizuar shtetëror, që shpreh e mbron interesat e klasës sunduese dhe që ushtrohet me dhunë nga një njeri ose nga një grup njerëzish; pushteti i diktatorit. Diktaturë ushtarake (politike, fashiste, monarkiste). Diktaturë absolute. Diktaturë e egër. Diktatura e skllavopronarëve (e feudalëve, e borgjezisë).

2. Sundimi i diktatorit në Romën e Vjetër; pushteti i tij i pakufizuar; koha gjatë së cilës ai e ushtronte këtë pushtet.

* Diktatura e proletariatit pushteti shtetëror i klasës punëtore që vendoset pas fitores së revolucionit socialist nën udhëheqjen e partisë marksiste, që shpreh e mbron interesat e të gjithë punonjësve dhe që është tipi me i lartë i demokracisë.

DIOQEZË f. 1. fet. Juridiksioni kishtar në të cilin ushtron funksionet e tij një peshkop a një prelat tjetër; peshkopatë (në vendet ku vepron kisha e krishterë).

2. Ndarje administrative në Romën e Vjetër.

DITIRAMB m. 1. Këngë korale e gëzueshme e plot gjallëri, që këndohej në Greqinë e Vjetër për nder të Dionisit, perëndisë së rrushit e të verës. Këndonin ditirambe.

DIVAN I m. 1. Kanape e gjerë dhe e gjatë si shtrat, me susta a me sfungjer dhe e veshur si kolltuk, që shërben për të ndenjur ose për t'u shtrirë; shtrat i ngushtë anës murit të dhomës, ku mund të ulemi ose të shtrihemi. Divan me raft. Hap divanin. 4. Këshilli i zyrtarëve me të lartë në oborrin e sulltanit të Turqisë, që kryente funksionet e gjykatës së lartë; dhoma ku mblidhej ky këshill.

DOMEN m. Tokë që ishte nën zotërimin e një pronari të madh, të një feudali, të një mbreti etj. Domene të gjera.

DUALIST mb.

2. Që është ndërtuar e vepron sipas parimeve e synimeve të dualizmit si

sistem borgjez i qeverisjes së shteteve shumëkombëshe. Shtet dualist. Monarki dualiste.

DUALIZËM m.

4. Sistem borgjez i qeverisjes në shtetet shumëkombëshe, ku klasat shfrytëzuese të dy kombeve më të mëdha e të privileguara bashkohen nën pushtetin e një monarku të vetëm e veprojnë në mënyrë mjaft të pavarur për të shtypur më lehtë kombësitë e tjera dhe të gjitha masat punonjëse. Dualizëm monarkik. Dualizmi austro-hungarez.

DUKAT m. 1. Monedhë e vjetër prej argjendi dhe më vonë prej ari, që përdorej në disa vende të Evropës Perëndimore.

DUKATË f. Shtet feudal a krahinë që sundohej e qeverisej nga një dukë; pronat, zotërimet e një duke.

DUKESHË f. 1. Fem. e DUK/Ë, ~A.

2. E shoqja ose e bija e dukës.

DUKË m. Titull i lartë aristokratësh, më i ulët se ai i princit; sundimtari i një dukate; ai që mbante këtë titull.

DYFEK MBAJTËS m. Luftëtar i armatosur me pushkë; pushkatar.

DYFEKTAR m. Pushkatar.

DYNDJE f. Dyndja e madhe e popujve. shpërnguljet e fiseve gjermane, vandale, hune, sllave etj. në shekujt III-VII, që vërshuan në zotërimet e Perandorisë Romake dhe luajtën një rol të rëndësishëm për shkatërrimin e saj.

2. Shumicë e madhe njerëzish që shpërngulen diku ose që vërshojnë në një drejtim të caktuar. Dyndjet e barbarëve. Dyndjet e sllavëve.

EFENDI m. 1. Titull nderi që i jepej një njeriu me shkollë në periudhën e pushtimit osman; zotëri.

EGËRSI f.

7. Periudha e parë e zhvillimit të shoqërisë primitive, pas së cilës vjen barbaria. Periudha e egërsisë.

ENKELEAS mb. Që lidhet me enkeleasit, që është karakteristik për enkeleasit, i enkeleasve; që është krijuar nga enkeleasit. Shteti enkeleas. Qytet enkeleas.

EPIROT m. kryes. Pjesëtar i popullsisë ilire të Epirit, që shtrihej në jug të Vjosës deri në gjirin e Ambrakisë (sot gjiri i Prevezës), banor i Epirit ose ai që e kishte prejardhjen nga Epiri. Shteti i epirotëve.

EPIROT mb. Që lidhet me Epirin ose me epirotët, që është karakteristik për Epirin ose për epirotët, i Epirit ose i epirotëve; që është krijuar nga epirotët. Fiset epirote. Shteti epirot. Qytetet epirote. Ushtria epirote. Kryengritësit epirote. Veshje epirote.

EPIROTAS m. kryes. Epirot.

EPIROTAS mb. Epirot.

EPISOD m.

2. let., Veprim i shkurtër a i pjesshëm që jepej në dramën e grekëve të vjetër ndërmjet koreve.

3. libr. Ngjarje a ndodhi e veçantë; ndodhi e dorës së dytë, zakonisht e shkurtër, në Vargun e ngjarjeve me rëndësi. Episod i papritur (i jashtëzakonshëm). Episode nga jeta.

EPITROP m.

2. Kujdestar a administrator i esnafëve zejtarë të krishterë.

EPOKË f. 1. Periudhë e gjatë dhe e rëndësishme historike, që dallohet nga disa tipare të veçanta zhvillimi; periudhë kohe që lidhet me një ngjarje të madhe a me një kthesë të rëndësishme në zhvillimin e diçkaje. Epokë historike. Epoka e re (e sotme). Epoka jonë. Epoka e socializmit. Epoka e Skënderbeut. Epoka e Rilindjes. Epoka e zbulimeve të mëdha gjeografike. Epoka e gurit (e bronzit, e hekurit). Nis (fillon) një epokë.

ESNAF m. 1. Shoqatë a lidhje e zejtarëve të pavarur në mesjetë, që bashkoheshin sipas profesionit; shoqatë a bashkim tregtarësh që tregtonin një lloj malli. Esnafet

e zejtarëve (e endësve, e farkëtarëve). Esnafet e tregtarëve.

2. ~Ë, ~ËT. Zejtari a tregtari që bënte pjesë në një shoqatë a bashkim të tillë.

ETRUSK mb. Që ka të bëjë me etruskët, që u përket etruskëve, i etruskeve; që është krijuar nga etruskët. Kultura (gjuha) etruske. Shkrimi etrusk. Mbishkrimet etruske.

Varre (monumente) etruske.

FAMILJE f. Familja me çifte.

FARAON m. Titull i mbretërve në Egjiptin e lashtë; mbreti në Egjiptin e lashtë. Faraonët e Egjiptit. Varret e faraonëve.

FENIKAS m. Pjesëtar i popullsisë së shtetit të lashtë të Fenikisë.

FENIKAS mb. Që ka të bëjë me Fenikinë ose me fenikasit, që është karakteristik për Fenikinë ose për fenikasit, i Fenikisë ose i fenikasve; që është krijuar nga fenikasit. Populli fenikas. Anijet fenikase. Gjuha (kultura) fenikase. Alfabeti fenikas.

FERMAN m. 1. Dekret a urdhër me shkrim i sulltanit në Perandorinë Osmane për një gradim, për një dekorim, për një shpërblim, për një dënim etj. Nxori (lëshoi) fermanin. E dha me ferman.

FEUD m. Pronë tokë e feudalit, që punohej nga bujkrobërit.

FIS m. 1. Grup njerëzish në shoqërinë primitive me lidhje të afërta gjaku, me gjuhë të përbashkët e me zakone të njëjta, që mbështetej në pronën e përbashkët dhe që ishte njësia bazë e organizimit të jetës së njerëzve e të prodhimit deri në lindjen e klasave; etnogr. grup njerëzish me gjuhë dhe zakone të përbashkëta, që jetojnë si një bashkësi me një prijës në krye. Fiset ilire. Fiset eskimeze. Fise primitive. Fise shtegtare. Gjuha e fisit. Udhëheqësi i fisit.

FISËM mb.

2. Që i përkiste shtresës së lartë aristokratike në shoqërinë feudale, që e

kishte origjinën nga një familje e pasur dhe me pozitë të privilegjuar; fisnik. Familje (shtëpi) e fisme.

FISNIK m.

2. Ai që bënte pjesë në shtresën me të lartë e të privilegjuar të klasës shfrytëzuese në shoqërinë feudale ose feudalo-borgjeze; pronar i madh tokash; titulli që u jepej njerëzve të kësaj shtrese. Shtresa e fisnikëve. Nga radhët e fisnikëve.

FISNIK mb.

2. Që ka të bëjë me shtresën me të lartë e të privilegjuar të klasës shfrytëzuese në shoqërinë feudale ose feudalo-borgjeze, që lidhet me aristokracinë feudale; që është karakteristik për fisnikët; i fisnikëve. Familje fisnike

FISNIKËRI f. 1

2. përmb. Shtresa me e lartë dhe me e privilegjuar e klasës shfrytëzuese në shoqërinë feudale ose feudalo-borgjeze, aristokracia feudale; tërësia e fisnikëve; parësia, shtresa me e lartë e një fisi. Fisnikëria feudale.

FLAMUR m.

6. shih BAJRAK, ~U 2. Malësia ndahej në flamurë.

FLAMURTAR m. 1. Ai që mban flamurin e një njësie ushtarake ose në një demonstratë, në një manifestim sportiv etj., flamur-mbajtës. Flamurtari i togës (i brigadës). Parakalojnë flamurtarët. 3. shih BAJRAKTAR, ~I 2.

FORUM I m. libr.

2. Shesh në Romën e vjetër ku bëheshin mbledhje të gjera të popullit, zhvilloheshin gjyqe, panairë etj.

FRANG m. 1. Njësia monetare bazë e Francës, e Belgjikës dhe e Zvicrës; monedhë që ka këtë vlerë. Frangu francez (zvicëran). Zhvleftësimi i frangut.

2. Njësia monetare bazë e shtetit shqiptar deri me 1946; monedha që kishte këtë vlerë. Frangu shqiptar.

- GALERË** f. det., Anije e vjetër luftime prej druri, e gjatë e me shumë rrema, që viheshin në lëvizje zakonisht nga të dënuarit me punë të rënda. Galerë romake (bizantine). Galerë piratësh. Flota e galerave.
- GARDHIM** m.
2. Grabitja e tokave dhe e pronave të fshatarëve anglezë nga fisnikët dhe rrethimi i tyre me gardh në periudhën e grumbullimit fillestar të kapitalit.
Gardhimet e rrënuan fshatarësinë angleze.
- GLADIATOR** m. Skllav ose rob luftime me trup të fuqishëm, që në Romën e vjetër e mbanin dhe e stërvitnin posaçërisht për ta vënë të përleshej për vdekje me sklevër a me robër të tjerë ose me kafshë të egra në arenën e cirkut. Shpatë gladiator. Ndeshjet e gladiatorëve. Kryengritjet e gladiatorëve.
- GOTË** m. vet. Fis i vjetër gjerman. Gotët e Lindjes (e Perëndimit).
- GOTISHTË** f. Gjuhë e grupit gjermanik, që flitej nga gotët, gjuha e gotëve.
- GRADISHTË** f. arkeol. Qytezë; rrënojat e një qyteze.
- GREKOMAN** m. 1. Ai që nën ndikimin e shkollës e të kishës greke kishte humbur ndjenjat atdhetare dhe përkrahte politikën e propagandën shoviniste greke (sidomos në shek. XIX).
2. si mb. ~, ~E. Që ka të bëjë me grekomanët, i grekomanëve. Borgjezia grekomanë. Kleri grekoman. Agjentët grekomanë.
- GRUP** m.
* Grup edukativ shih tek **EDUKATIV**, ~E.
- GUR** m. 1. Koha (periudha, epoka) e gurit periudha e hershme e shoqërisë njerëzore, kur njerëzit përdornin vegla prej guri.
- GURËHEDHËS** m. Armë e vjetër për të hedhur larg gurë të mëdhenj.
- GJINI** f. 1. Grup njerëzish me lidhje gjaku e me prejardhje nga një paraardhës i përbashkët, që ishte njësi ekonomike e shoqërore bazë në komunitetin primitiv. Gjini amtare. Gjini atërore. Lidhjet e gjinisë. Anëtarët e gjinisë. Emri i gjinisë. Plaku i gjinisë.
- GJOKSORE** f. 1. Parzmore.
- GJUNJËSE** f.
2. Pjesë e pajimit të luftëtarëve në kohët e vjetra, që mbronte gjurin nga goditjet me armë të ftohta.
- GJYSMATAR** m. 1. Secili nga të dy bujqit e varfër, që vinin në zgjedhje nga një ka për të punuar me radhë arat e veta; sembër.
2. Fshatar pa tokë, që ishte i detyruar të punonte tokën ose të ruante e të kulloste bagëtinë e një pronari dhe t'i jepte atij gjysmën e prodhimit.
- GJYSMATARI** f. Formë për shfrytëzimin e fshatarëve pa tokë, që ishin të detyruar t'i jepnin gjysmën e prodhimit pronarit, nga i cili merrnin tokën ose bagëtinë me qira. Sistemi i gjysmatarisë.
- HARAÇ** m. 1. Detyrim a taksë që i jepte ose i paguante një shtet një shteti tjetër kur mundej prej tij a kur pranonte t'i nënshtrohej atij.
2. Taksë e veçantë që jepte në të holla ose në natyrë popullsia jomyslimane gjatë kohës së pushtimit feudal ushtarak osman. Haraç për kokë. Haraç për tokën. Paganin haraçin.
- HARAÇPAGUES** mb. 1. Që i paguante haraç një shteti tjetër, kur mundej prej tij a kur pranonte t'i nënshtrohej atij. Vend (shtet) haraçpagues.
- HARKËTAR** m. Luftëtar që qëllonte me hark, shigjetar.
- HARKMBAJTËS** m. Harkëtar.
- HEKUR** m. Koha (periudha) e hekurit periudha historike rreth një mijë vjet para erës së re, kur nisi të punohej hekuri (pas periudhës së bronzit).

- HESHTAR** m. Luftëtar i armatosur me heshtë, ai që luftonte me heshtë, heshtëmbajtës, shtizar. Heshtarët e Skënderbeut. Sulmi i heshtarëve.
- HESHTËMBAJTËS** m. Heshtar, shtizar.
- HOBE** f. sh
2. Armë e vjetër që përdorej në luftë për të hedhur gurë. Hobe e madhe.
- HOBETAR** m. Luftëtar që përdorte hobenë për të hedhur gurë.
- HORDHI** f. sh 1. Emri i njërit prej bashkimeve shtetërore që u krijuan pas copëtimit të shtetit mongol të Çengiskanit; emri i bashkimit shtetëror të fiseve endacake turke në mesjetën e hershme; ushtria e madhe barbare e këtyre shteteve. Hordhia e Artë. Hordhitë mongole. Hordhitë turke.
- HUN** m. kryes. Populli endacake me prejardhje turanike, e cila u dynd në shekullin e katërt të erës sonë nga Azia në Evropë. Dyndja e hunëve.
- ILEGALITET** m. 2. përmb. Tërësia e organizatave që luftonin kundër pushtuesve të huaj dhe veglave të tyre në Shqipëri gjatë Luftës Nacionalçlirimtare duke punuar e vepruar në mënyrë konspirative (Partia Komuniste e Shqipërisë dhe organizatat e masave të udhëhequra prej saj). Njerëzit (luftëtarët, heronjtë) e ilegalitetit.
- ILUMINIST** m. 1. Përfaqësues i rrymës dhe i lëvizjes iluministe në Evropë në shekujt XVII-XVIII; pasues e përçues i ideve iluministe në Shqipëri në shekullin XIX në kohën e Rilindjes Kombëtare; pasues i iluminizmit, ndriçimtar. Idetë e iluministëve. Veprat e iluministëve. Iluministët francezë. Iluministët shqiptarë të shek. XIX.
- ILUMINIST** mb. 1. Që ka të bëjë me iluminizmin ose me iluministët e shekujve XVII-XVIII në Evropë, i iluminizmit ose i iluministëve; që ka të bëjë me përhapjen dhe me vënien në jetë të ideve të iluminizmit në Shqipëri në shek. XIX. Rrymë iluministe.
- INKUIZION** m. 1. Organizatë terroriste policore e gjyqësore e kishës katolike, e themeluar në shekullin XIII, që ndiqte, burgoste e zhdukte mizorisht njerëzit përparimtarë, të cilët me veprën e me punën e tyre, me shpikjet, me zbulimet e me studimet e tyre hidhnin poshtë dogmat fetare dhe dilnin kundër sundimit të kishës. Koha e inkuizionit. Gjyqi i inkuizionit. Zjarret (burgjet) e inkuizionit. U dënua (u burgos, u dogj) nga inkuizionit.
- INKUIZITOR** m. 1. Gjykatës i inkuizionit. Pamje e egër prej inkuizitori. U gjykua (u dënua) nga inkuizitorët.
- IRREDENTIST** m. libr. 1. Përkrahës i irredentizmit.
- IRREDENTIZËM** m. libr. 1. Lëvizje politike e nacionalistëve italianë përpara dhe gjatë Luftës së Parë Botërore, që kërkonte t'i jepeshin Italisë tokat me popullsi italiane të pushtuara nga Austro-Hungaria.
- IZRAELIT** m. 1. Pjesëtar i fiseve të vjetra të hebrenjve; hebre.
2. Shtetas i Izraelit.
- JENIÇER** m. Ushhtar këmbësor i trupave të zgjedhura osmane, që ishte marrë zakonisht nga të krishterët e vendeve të pushtuara prej Turqisë ose ishte zënë rob dhe që në vogëli ishte stërvitur e përgatitur për luftë. Komandanti (agai) i jeniçerëve. Sulmuan
(u thyen) jeniçerët.
- KADI** m. Zyrtar në kohën e sundimit osman, që kryente detyrën e gjykatësit dhe detyra të tjera civile e fetare; gjykatës, zakonisht hoxhë, që gjykonte çështje civile e fetare sipas shariatit. Me një dorë rrëmbente kadiu, me tjetrën myftiu.
- KAJMEKAM** m. Zëvendës i guvernatorit në një krahinë, mëkëmbës; zyrtari i parë që sundonte në një krahinë të caktuar (gjatë sundimit osman); nënprefekt. E bënë kajmekam.

- KALA** f. 1. Vend i rrethuar me mure të larta e të trasha dhe i pajisur me mjete luftarake për t'u mbrojtur për një kohë të gjatë; kështjellë. Kala ilire (mesjetare). Kalaja e Krujës. Porta e kalasë. Muret (kullat) e kalasë. E morën (e pushtuan) kalanë.
- KALIF** m. Titull që mbante në disa vende myslimane kryesundimtari, i cili kishte në duart e veta pushtetin më të lartë politik e fetar dhe e quante veten pasardhës të Muhametit (në vendet arabe deri në shek. XIII dhe më vonë në Egjipt e në Turqi në kohën e sulltanëve). Kalifi i parë. Kalifi i Bagdadit. U bë kalif.
- KALORËS** m.
3. Titull që u jepej feudalëve oborrtarë; feudal që i përkiste shtresës së aristokracisë ushtarake (në disa vende të Evropës).
- KANIBAL** m. 1. Njeri që hante mish njeriu, njeriingrënës (në fazat me të ulëta të zhvillimit të shoqërisë).
- KANIBALIZËM** m. 1. Përdorimi si ushqim i mishit të njeriut nga njerëzit (në fazat më të ulëta të zhvillimit të shoqërisë).
- KANOSJAR** m. 1. Bekçi i fshehtë që caktohej nga pleqësia e fshatit ose nga kryeplaku për të ruajtur arat, vreshtat etj.
2. Ai që gjobiste fshatarin, i cili kishte dëmtuar vetë ose me bagëtitë e tij arën a mallin e dikujt.
- KANUN** m. 1. Përmbledhje ligjesh e normash të pashkruara, të trashëguara brez pas brezi, që pasqyrojnë gjendjen ekonomiko-shoqërore të periudhave të kaluara dhe që në kohën e vet mbronin interesat e klasave e të shtresave të caktuara shoqërore; tërësia e normave të së drejtës zakonore. Kanuni i Skënderbeut. Kanuni i Lek Dukagjinit.
I dogjëm (i shkatërruam) kanunet e vjetra.
- KANUNIZOJ** kal. libr. 1. E fut në kanun, e bëj ligj të pashkruar. Kanunizuan zakonin e ekzogamisë.
- KAPEDAN** m. 4. Bajraktar.
- KAPSOLLAQE** f. Pushkë e vjetër, e gjatë, që mbushej nga gryka dhe shkrehej me shkëndijat që dilnin nga kapsolla.
- KARTAGJENAS** mb. Që lidhet me Kartagjenën (qytet e shtet i lashtë në Afrikën e Veriut) ose me kartagjenasit, që ishte karakteristik për Kartagjenën ose për kartagjenasit, i Kartagjenës ose i kartagjenasve; që është krijuar nga kartagjenasit. Anije kartagjenase. Ushtria kartagjenase. Tregtarët kartagjenas. Arti kartagjenas.
- KATAKOMB** m. 1. Galeri e nëndheshme me disa tunele të gjata, ku, në Romën e vjetër, të krishterët e kohëve të para fshiheshin, kryenin shërbesat fetare ose varrosnin të vdekurit. Katakombet e Romës.
- KATAPULTË** f. 1. Armë e vjetër që përdorej gjatë rrethimit të një kështjelle për të goditur ushtrinë armike me gurë të mëdhenj a me trarë të mprehur ose për të hedhur shigjeta me lëndë ndezëse (zift, katran etj.). Katapultë romake.
2. Mjet për të ngritur menjëherë aeroplanin nga aeroplanmbajtësja; mekanizëm për shkëputjen automatike të pilotit nga aeroplani në rast rreziku. Katapulta e aeroplanit reaktiv. U hodh me katapultë.
- KATUND** m. 1. Fshat. Katund i ri. Katund më katund. Katund me njëqind shtëpi. Banoj (jetoj) në katund. U ngrit gjithë katundi.
2. Bashkësi e njerëzve, që merreshin kryesisht me blegtori e bënë një jetë shtegtare; vendbanimi i përkohshëm i këtyre njerëzve; fshat i madh, me shtëpi të shpërndara e larg njëra-tjetrës.
- KATUNDAR** m. 1. Fshatar.
2. Ai që ishte në krye të katundit, udhëheqësi i katundit; çelnik.
- KATUNDARI** f. 1. Fshatarësi.
2. Bashki.

KAVALL m. 2. Pushkë e vjetër me një tytë, që mbushej nga gryka dhe shkruhej me gur stralli.

KËMISHË f. Këmishë hekuri. veshje e sipërme prej metali, që mbanin kalorësit për t'u mbrojtur nga goditjet e shpatave ose të shtizave.

KËMISHËKUQ m. Vullnetar në ushtrinë e Garibaldit, që luftonte për bashkimin e Italis ë(në shek. XIX).

KËSHTJELLAR m. 1. Feudali që ishte zot i një kështjelle.

2. Komandanti i luftëtarëve që mbronin një kështjellë; luftëtari që mbronin një kështjellë.

KËSHTJELLË f. 1. Vend i rrethuar me mure të larta e të trasha, i pajisur me shrapelle me bedena e me mjete të tjera për t'u mbrojtur për një kohë të gjatë nga sulmet e armiqve; vendbanimi i feudalëve, i fortifikuar dhe i mbrojtur mirë; banesë e fortifikuar feudale; kala. Kështjellë e vjetër (mesjetare). Kështjella e Krujës

KLAN m. 1. Grup shoqëror i përbërë nga njerëz të një gjaku, që organizonte punën dhe jetën në mënyrë të veçuar nga të tjerët (në bashkësinë primitive).

KMESËTAR m.

2. Luftëtar që luftonte me kmesë (në ushtrinë e Skënderbeut).

KOÇOBASH m. Kryeplaku i fshatit (në kohën e sundimit turk).

KOHORTË f. Njësi ushtarake që ishte sa një e dhjeta e legjionit në Romën e lashtë; njësi ushtarake me 300-600 luftëtarë. Kohortat romake. Kohorta e Skënderbeut.

KOKË f. Taksë për kokë. Okë e kokë. Kokë për kokë secilin a secilit; për çdo njeri veç e veç. Rrogë e kokë. Plumb e kokë.

KOKËMBROJTËSE f. Lloj helmete që e mbanin luftëtarët për të mbrojtur kokën e fytyrën.

KOLABORACIONIST m. 1. Ai që ka bashkëpunuar me pushtuesit fashistë e nazistë dhe ka tradhtuar Atdheun gjatë Luftës Nacionalçlirimtare.

2. Ai që bashkëpunon me pushtuesin dhe tradhton atdheun e vet; tradhtar.

KOLABORACIONIZËM m. 1. Bashkëpunim i tradhtarëve të Atdheut ose i përfaqësuesve të klasave sunduese me pushtuesit fashistë e nazistë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare.

2. Bashkëpunim i tradhtarëve të atdheut me pushtuesin; tradhti.

KOLON m. 1. Skllav i liruar a fshatar i lirë, që merrte me qira një copë tokë nga një pronar i madh dhe ishte i detyruar të paguante për këtë një taksë në natyrë e në të holla

(në Romën e vjetër).

2. në Popullsi e shtetit pushtues kapitalist a imperialist, që shkon të banojë në vendin e pushtuar, bëhet aty zot i tokës ose i pasurive të tjera të vendit dhe i shfrytëzon ato për nevojat e veta.

KOLONË f.

* Kolona e pestë

a) grup kundërrevolucionar, i përbërë prej spiunësh, diversantësh, fashistësh dhe armiqsh të tjerë, që vepronin në prapavijën e Spanjës republikane gjatë viteve 1936-1939;

b) grup kundërrevolucionar, zakonisht i vënë nga zbulimi i huaj, që zhvillon veprimtari subversive antishtetërore në vende me regjim demokratik e popullor; grup kundërrevolucionar që zhvillon veprimtari përçarëse në gjirin e partive komuniste ose të një partie a organizate përparimtare.

KOLONI f. 1. Vend i pushtuar me forcë nga një shtet i huaj kapitalist, imperialist që humb pavarësinë për një kohë të gjatë dhe shtypet, shfrytëzohet prej tij në mënyrë të egër e të pamëshirshme.

2. Pjesë e popullsisë së një vendi, që është shpërngulur për arsye të ndryshme

e ka shkuar në një vend tjetër, ku jeton e punon duke ruajtur zakonet e gjuhën amtare; ngulim. Kolonitë shqiptare jashtë Atdheut. Kolonia shqiptare e Egjiptit (e Bukureshtit).

3. Vend a qytet i populluar me kolonë pushtues (në kohën e Greqisë e të Romës së vjetër). Kolonitë greke. Koloni romake.

KOMIT m. Kryengritës që dilte malit e luftonte për lirinë e atdheut dhe për drejtësi shoqërore kundër shtypësve e shfrytëzuesve. Çeta e komitëve. Doli komit.

KOMUNË f. 1. edhe Njësi administrative lokale, që përfshin zakonisht disa fshatra ose një krahinë; organ shtetëror lokal i një njësie të tillë; ndërtesa ku është vendosur ky organ (në disa vende të tjera; në të kaluarën edhe në Shqipëri). Tokat e komunës.

* Komuna e Parisit shtet revolucionar i masave punonjëse, që u krijua në Paris pas fitores së revolucionit të vitit 1871 dhe që ishte përpjekja e parë në botë për të vendosur diktaturën e proletariatit.

KOMUNIKATË f. 1. Njoftim zyrtar për çështje të rëndësishme kombëtare ose ndërkombëtare, që bëhet botërisht me anë të shtypit, të radios etj., kumtim. Komunikatë zyrtare.

Komunikatë ushtarake. Sipas një komunikate.

2. Fletë e shtypur, nxirrej rregullisht gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, ku jepeshin njoftime për luftën e popullit tonë kundër pushtuesve fashistë e kundër tradhtarëve të vendit dhe për luftën antifashiste të popujve të tjerë.

KONSULL m. 1. dipl. Përfaqësues zyrtar i një shteti në një qytet të një shteti tjetër, që është ngarkuar të mbrojë interesat e bashkatdhetarëve pranë autoriteteve lokale e interesat tregtare të shtetit të vet dhe të merret me legalizimin e dokumenteve, me veprime të gjendjes civile, me lëshimin e pasaportave, të vizave etj.

Konsull i përgjithshëm grada më e lartë në hierarkinë konsullore; ai që ka këtë gradë.

Konsull nderi shtetas i një vendi që caktohet nga një shtet tjetër të kryejë për të disa funksione konsullore si detyrë nderi e pa shpërblim.

2. Secili nga dy sunduesit e zgjedhur në Republikën e Romës së vjetër, që kishin në dorë pushtetin e lartë; titulli që i jepej secilit prej këtyre sunduesve.

KONSULLATË f. 1. dipl. Agjenci zyrtare e një shteti që është vendosur në një qytet të një shteti tjetër për të siguruar mbrojtjen e interesave të shtetasve të vet pranë autoriteteve lokale dhe mbrojtjen e interesave tregtare të shtetit të vet; ndërtesa ku është vendosur kjo agjenci. Konsullata shqiptare. Me anën e konsullatës. Shkoj në konsullatë.

2. Koha kur pushteti i lartë ishte në duart e dy konsujve (në Republikën e Romës së vjetër).

KONT m. Titull aristokratësh më i lartë se ai i baronit dhe më i ulët se i markezit; ai që mbante këtë titull.

KONTESHË f. 1. Fem. e KONT, ~I.

2. E shoqja ose e bija e kontit.

KORDHË f. Shpatë, që vjen pak e kthyer në majë dhe që pret vetëm nga njëra anë; këllëç.

Luftonin me kordha.

KORDHËTAR m. 1. Ai që luftonte me kordhë.

KORPARMATË f. usht. 1. Njësia më e madhe në Ushtrinë tonë nacionalçlirimtare.

2. shih TRUPARMAT/Ë, ~A.

KORPORATË f. 1. Bashkim zejtarësh a tregtarësh të një vendi ose krahine në një organizatë për të mbrojtur më mirë interesat e tyre, esnaf (në rendin feudal). Korporata e zejtarëve (e tregtarëve).

4. në Organe të krijuara nga regjimi fashist në Itali për t'u shërbyer

monopoleve kapitaliste, duke u përpjekur të shuanin luftën e klasave e të siguronin pajtimin e bashkëpunimin ndërmjet sipërmarrësve e punëtorëve. Dështimi i korporatave fashiste.

KOSHADHE f. 1. Patrullë.

KRAHINAR m. edhe Nëpunës i emëruar nga qeveria, që sundon në një njësi administrative; kryetar i komunës së një krahine. U emërua krahinari. Shkoi te krahinari.

KRAHINARI f. edhe Njësi administrative që përfshin zakonisht disa fshatra dhe që drejtohet nga një nëpunës i emëruar nga qeveria.

KRAHINË f. 1. Pjesë e një vendi, që formon një njësi dhe dallohet prej të tjerave nga disa veçori gjeografike, gjuhësore, ekonomike etj., nga veshjet, zakonet, mënyra e jetesës etj.; zonë; vend që shtrihet larg nga qendra administrative; vendi ku ka lindur dikush, anë. Krahinë malore (fushore). Krahinë e zhvilluar (e pazhvilluar, e prapambetur). Krahinë bujqësore (industriale). Krahinat e veriut (e jugut). Krahinat e çliruara

(e paçliruara). Krahinat e pushtuara. Nga krahina jonë. E folmja e krahinës së... Në çdo krahinë. Pa dallim krahine. Muzikë e valle nga krahinat.

2. edhe Njësi territoriale-administrative brenda një shteti, e cila ka një kryeqendër; qark.

KRYEQINDËS m. Komandant i një qindësheje në ushtrinë e Romës së lashtë, komandant i qindëseshes.

KRYQËZATË f. 1. kryes. Fushata ushtarake me qëllime pushtuese, që bënin gjatë shekujve

XI-XIII në Lindjen e Afërme etj. feudalët e Evropës Perëndimore, të nxitur nga kisha katolike gjoja për të shpëtuar vendet e shenjta ose krishterimin nga të pabesët. Kryqëzata e parë (e dytë...). Në kohën e kryqëzatave.

KRYQËZIM m. 1. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve KRYQËZUJ, KRYQËZOHEM.

2. Mënyrë e vjetër e dënimit me vdekje, duke e mbërthyer të dënuarin pas një druri me krahë hapur si në kryq.

KRYQËZUJ kal.

2. E mbërthej dikë pas një druri me krahë hapur si në kryq (mënyrë e vjetër e dënimit me vdekje).

KRYQËZUAR mb.

2. Që është mbërthyer pas një druri me krahë hapur si në kryq (sipas një mënyre të vjetër të dënimit me vdekje). Vdiq i kryqëzuar.

KUESTOR m. 1. Ruajtësi i thesarit të shtetit dhe administruesi i tij në Romën e vjetër; hetues e gjykatës për çështje penale.

2. Shef i policisë në qytetet e mëdha të Italisë, drejtues i kuesturës (gjatë pushtimit fashist italian edhe në Shqipëri). Kuestori fashist. E vranë kuestorin.

KUJRI f. 1. Pyll, kullotë, tokë a vend tjetër që shfrytëzohej bashkërisht nga gjithë katundi.

2. përd. mb. sipas kuptimit të emrit. Tokë kujri.

KURORË f.

4. Rreth i metaltë, zakonisht i stolisur me ar e me gurë të çmuar, që mbanin (e që në disa vende mbajnë edhe sot) në kokë perandorët, mbretërit etj. si shenjë të pushtetit të tyre; pushteti, sundimi i monarkut; vetë mbreti a perandori; përmb. familja mbretërore. Kurora mbretërore. Kurora e perandorit (e mbretëreshës). Pasuritë e kurorës. Fjalimi i kurorës fjalimi i mbretit në parlament në disa vende borgjeze.

KURORËZIM m. 1. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve KURORËZUJ, KURORËZOHEM.

3. Ceremonia që bëhej për të kurorëzuar një mbret, një perandor etj. Kurorëzimi i mbretit.

KURORËZOJ kal.

2. I vë kurorën një monarku a një sundimtari, e shpall mbret a sundimtar duke i vënë mbi kokë një kurorë, si simbol i pushtetit. Kurorëzoi mbretin.

LABEAT m. kryes. Pjesëtar i njërit prej fiseve kryesore ilire, që banonte në trojet nga Liqeni i Shkodrës deri thellë në Malësinë e Veriut. Fisi i labeatëve.

LABEAT mb. Që ka të bëjë me labeatët, që u përket labeatëve, i labeatëve; që është krijuar nga labeatët. Fis labeat. Monedhë labeate. Veshje labeate.

LABIRINT m. 1. Rrjet i ngatërruar kalimesh e shtigjesh, të mbidheshme e të nëndheshme, nëpër të cilat mund të dilet diku, por me shumë vështirësi. Hyri në një labirint.

2. Ndërtesë e madhe me shumë të ndara e me korridore të ngatërruara, ku ishte e vështirë të gjendej rruga e daljes (në Egjiptin dhe në Greqinë e lashtë).

LATIFOND m. 1. Pronë toke e madhe në kohën e Perandorisë Romake, që ishte në duart e njerëzve të shtresave të larta. Latifondet romake. Latifondet e skllavopronarëve.

2. Pronë toke e madhe në vendet kapitaliste e feudo-borgjeze, që është në duart e të pasurve dhe që punohet me bujq të shfrytëzuar, me mënyra e mjete të prapambetura. Latifonde të mëdha. Latifondet kapitaliste. Pronari i një latifondi.

LEGJION m. 1. Njësia ushtarake themelore në ushtrinë romake, që përbëhej nga shumë kohorta dhe që kishte rreth gjashtë mijë luftëtarë këmbësorë e kalorës.

Legjionet romake. Kohortat e legjionit.

LIDHJE f. Lidhja për përhapjen e shkollave shqipe.

16. Bashkim politik e shoqëror, me karakter kombëtar a ndërkombëtar, që vepron si një organizatë e u shërben qëllimeve të caktuara. Lidhja Shqiptare e

Prizrenit. Lidhja e Lezhës. Lidhja e Kombeve. organizatë politike ndërkombëtare në periudhën midis Luftës së Parë e Luftës së dytë Botërore, në të cilën përfaqësohej një pjesë e shteteve (sot Organizata e Kombeve të Bashkuara). Lidhja (aleanca) e shenjtë.

LIKUIDATOR m. libr.

2. Përkrahës i një rryme politike reacionare në gjirin e Partisë Punëtore Social-demokrate Ruse (në vitet 1908-1912), që synonte të asgjësonte partinë ilegale të proletarietit duke e kufizuar veprimtarinë e saj brenda formave legale.

LIRË mb.

3. Që nuk ishte skllav a bujkrob, por kishte të drejtën e pronësisë mbi tokën, mbi mjetet e punës e mbi prodhimet, si dhe disa të drejta qytetare (në rendin skllavopronar e në atë feudal); që nuk i është nënshtruar sistemit të timareve e të çifligjeve (në vendin tonë gjatë pushtimit osman). Fshatarët e lirë dhe bujkrobërit. Fshatarësia e lirë e malësive.

LIRI I f.

3. vet. nj. Gjendja e një njeriu, i cili nuk ishte skllav a bujkrob (në rendin skllavopronar e në atë feudal).

LIROJ kal.

3. I jap lirinë një skllavi a bujkrobi (në rendin skllavopronar e në atë feudal).

LIRUAR mb.

3. Që kishte fituar lirinë. Skllav i liruar.

LOT m. kryes.

2. Vaj, vajtim. Lëndina e lotëve. shesh në të dalë të qytetit, ku njerëzit ndaheshin me të afërmit e tyre kur shkonin në kurbet. S'biem në lot. Armiku mbolli lot e mjerim.

MADH mb.

11. Që ka shumë prona a pasuri, që është i fuqishëm nga ana ekonomike, i pasur; kund. i vogël. Pronar i madh. Zejtaret e mëdhenj. Borgjezia e madhe në vendet kapitaliste.

MAGNAT m.

2. Pronar i madh tokash, feudal i madh.

MAGJISTRAT m. Zyrtar i lartë shtetëror i zgjedhur, që kishte pushtet me karakter juridik, administrativ ose politik (në Romën e lashtë); titulli i këtij zyrtari.

Magjistratët e Romës (e Athinës).

MANDAT m. 1. drejt. Fuqi e plotë që i jepet dikujt për të vepruar ose për të ushtruar një të drejtë gjatë një kohe të caktuar; dokumenti zyrtar që vërteton këtë të drejtë. 2. E drejtë që u jepte Lidhja e Kombeve disa shteteve anëtare të saj për të administruar disa territore që iu shkëputën fuqive të mundura në Luftën I Botërore. Territore nën mandat. Sistemi i mandateve formë e kamufluar e shtypjes koloniale.

MARKEZ m. Titull aristokratësh, që ishte një shkallë më lart se ai i kontit dhe një shkallë më poshtë se ai i dukës; ai që mbante këtë titull.

MARTALLOZ m. 1. Njeri i armatosur që ngarkohej për të mbajtur rregullin e qetësinë në një krahinë (në kohën e sundimit osman). Repartet e martalozëve.

MATRIARKAT m. Formë e hershme e shoqërisë njerëzore (në periudhën e komunës primitive), ku rolin drejtues në gjithë jetën ekonomike, shoqërore e familjare e luante gruaja dhe ku grupet gjinore krijoheshin sipas lidhjeve të afriës në vijën e grave.

Epoka e matriarkatit. Matriarkati u zëvendësua nga patriarkati.

MESAP m. kryes. Pjesëtar i një popullsie të vjetër, me prejardhje nga ilirët, të shpërngulur në Italinë Jugore para erës së re.

MESAP mb. Që ka të bëjë me mesapët, që u përket mesapëve, i mesapëve; që është krijuar nga mesapët. Gjuha mesape. Mbishkrime mesape.

MESAPISHTË f. Gjuha e mesapëve, që flitej në viset jugore të Gadishullit Italik.

MESËM mb. Koha e mesme. mesjeta.

MOLOS m. kryes. Pjesëtar i njërit prej fiseve epirote, që banonte në viset që nga jugu i Vjosës së Sipërme e deri në pellgun e Janinës. Mbishkrimet e molosëve. Lidhja e molosëve.

MYTESARIF m. Kryetar i administratës së një sanxhaku në kohën e perandorisë osmane. Urdhri i mytesarifit.

NAHIJE f. vet. 1. Krahinë, anë. Nahija e Shkodrës. Është nga nahija jonë.

2. Nënndarje administrative, që përfshinte disa fshatra në kohën e pushtimit osman në Shqipëri; komunë.

NAPOLON m. Monedhë ari me vlerë prej njëzet frangash ose prej njëqind lekësh.

NAZIBALLIST m. Pjesëtar i forcave të përbashkëta të nazistëve gjermanë dhe të organizatës tradhtare të «Ballit Kombëtar» që luftonin kundër Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Lufta kundër naziballistëve.

NAZIBALLIST mb. Që kishte të bënte me forcat e përbashkëta të nazistëve gjermanë dhe të organizatës tradhtare të «Ballit Kombëtar», që luftonin kundër Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Forcat naziballiste.

NDRIÇIM m.

4. Iluminizëm. Shekulli i ndriçimit.

NIHILIST m.

2. Pasues i nihilizmit. Nihilistët rusë të shekullit XIX.

NIHILIZËM m. 1. Drejtim mendor e politik që u përhap në Rusi në vitet gjashtëdhjetë të shekullit XIX dhe që mbante një qëndrim mohues ndaj traditave e vlerave shoqërore e kulturore dhe ndaj rendit shoqëror në tërësi.

2. Mohim i plotë i parimeve, i normave morale, i vlerave kulturore e i çdo tradite të një shoqërie; qëndrim mohues dhe nënvlerësues ndaj çdo gjëje, pa dallim.

Nuk biem në nihilizëm.

- NIZAM** m. Ushtar i shërbimit të detyrueshëm në kohën e Turqisë; rekrut. Merrnin djemtë nizamë. Nuk pranonin të shkonin nizamë. Këngët e nizamit. folk.
- NORMAN** m. Pjesëtar i fiseve skandinave që zbritën nga Veriu për të pushtuar e grabitur vendet e ndryshme të Evropës në shekujt VIII-XI. Sulmet (pushtimet) e normanëve. Luftërat kundër normanëve.
- NORMAN** mb. Që lidhet me normanët, i normanëve, që është karakteristik për normanët. Fiset normane. Pushtimet normane.
- NJËSIT** m. usht. 1. Grup i vogël partizanësh ose ilegalësh gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, që kryente veprime të armatosura ose detyra të tjera. Njësit partizan. Njësitet guerile. Njësi i fshatit. Komandanti i njësitit. Aksionet e njësitit.
- OLIGARKI** f. 1. Formë qeverisjeje në kohën e vjetër e në mesjetë, kur pushtetin e kishte në duart e veta një rreth shumë i ngushtë skllavopronarësh e aristokratësh të pasur, të cilët shtypnin e shfrytëzonin pa mëshirë robërit e shtresat e varfra; përmb. grupi i vogël sundues në këtë formë qeverisjeje. Oligarkia skllavopronare (aristokrate).
Lufta kundër oligarkisë.
2. Sundimi politik dhe ekonomik i një grupi të vogël miliarderësh në vendet imperialiste, të cilët përfaqësojnë diktaturën e kapitalit financiar dhe të monopoleve; përmb. pronarët e monopoleve të mëdha që bëjnë pjesë në këtë grup dhe që nxjerrin fitime të shumta duke shfrytëzuar egërsisht masat e gjera punonjëse në vendet kapitaliste, si edhe vendet e prapambetura. Oligarkia financiare.
- OLIMPIADË** f. 1. Periudhë prej katër vjetësh ndërmjet dy lojërave olimpike, që në Greqinë e lashtë merrej si matëse e kohës.
- OLIMPIK** mb. 1. Që zhvillohej një herë në çdo katër vjet në Greqinë e lashtë në Olimpi (për lojërat atletike).
- ORGJI** f. 1. Festë që bëhej në Greqinë e lashtë për nder të Dionisit, perëndisë së rrushit dhe të dëfrimit.
- OXHAK** m.
3. fig. Familje e vjetër dhe e dëgjuar, shtëpia e parë dhe e njohur nga të tjerët; familje e shtresës së pasur. Oxhak i madh. Oxhaqet feudale. Djalë oxhaku. Ishte oxhak (ishte prej oxhaku). Iku koha e oxhaqeve.
- OXHAKËRI** f. përmb. Njerëzit e shtresës së pasur; klasa feudale e vendit, paria feudale. Oxhakëria e vendit.
- OXHAKËSI** f. përmb. shih OXHAKËRI, ~A.
- PADISHAH** m. Titull i sulltanit në Perandorinë Osmane dhe i sundimtarit absolut në disa vende të Lindjes; ai që mbante këtë titull.
- PAFE** mb. 1. Që nuk beson në dogmën e fesë, që nuk pranon asnjë fe; që hiqte dorë nga feja sunduese dhe që për këtë ndiqej nga përfaqësuesit e saj, heretik. Njeri i pafe.
- PAN** m. Çifligar i madh në Poloni dhe në disa vende të tjera sllave. Panët polakë. Pronat e panëve.
- PANCIR** m. Parzmore. Pancir çeliku. Panciri i Skënderbeut. I veshur me pancir.
- PANEGJIRIK** m. 1. Fjalim që mbante një gojëtar për të ngritur lart botërisht bëmat e një heroi a të një njeriu të shquar, për të lavdëruar një qytet etj. Panegjirik për heroin.
- PANEGJIRIST** m. 1. Ai që shkruante ose mbante një panegjirik. Panegjiristët e lashtë.
- PANTEON** m. 1. Tempull që grekët dhe romakët e vjetër u kushtonin të gjitha perëndive. Panteoni grek (romak).
2. Ndërtesë madhështore ku ruhen eshtrat e njerëzve më të shquar të një kombi a të një vendi.

PARAÇLIRIM m. 1. Periudha para 29 Nëntorit të vitit 1944, kur Shqipëria u çlirua përfundimisht nga pushtuesit e huaj dhe tradhtarët e vendit. Shqipëria e Paraçlirimit. Periudha e Paraçlirimit. Letërsia e Paraçlirimit. Shkollat e Paraçlirimit. Në krahasim me Paraçlirimin.

2. Koha përpara çlirimit të një vendi nga pushtuesit e huaj.

PARTIN m. Pjesëtar i njërit nga fiset ilire, që banonte në brigjet e lumit të Matit.

PARTIZAN m.

2. Anëtar i çetave dhe i njërive të tjera që morën pjesë në luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar kundër pushtuesve fashistë dhe tradhtarëve të vendit. Partizanit e Brigadës I Sulmuese. Aksionet e partizanëve. Heroizmat (trimëritë) e partizanëve. Doli (u bë) partizan. Ka qenë partizan.

PARTIZAN mb. që ka të bëjë me partizanët gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar. Radhët partizane. Këngë partizane. Zjarri partizan. Jeta partizane. Heroizmi partizan. Ylli partizan. Miqësia partizane. Spitali partizan.

PARZMAK m. Parzmore. Parzmak çeliku.

PARZMORE f. Veshje prej metali, e gjatë deri në brez, që mbronte luftëtarët në kohët e vjetra gjatë ndeshjeve me armë të ftohta. Parzmore çeliku. Veshi parzmoren. I shpoi parzmoren.

PASHA m. 1. Titull që u jepej funksionarëve të lartë civilë e ushtarakë në perandorinë osmane; ai që mbante këtë titull; ai që mbante këtë titull edhe pa funksione zyrtare. Pashallarët e Turqisë. Pasha me dy (me tri) tuja. U bë pasha.

2. Qeveritar civil e ushtarak në krye të një sanxhaku a të disa sanxhakëve në perandorinë osmane. Pashai i Janinës. I thyen ushtritë e pashallarëve.

PASHALLËK m. 1. Titulli i pashait; gradë, mbajtësi i së cilës kishte titullin pasha. Iu dha pashallëku.

2. Krahinë ose vend që qeverisej nga një pasha. Pashallëqet në Ballkan. Sistemi i pashallëqeve.

3. Formacion i madh shtetëror, i përbërë nga disa sanxhakë të sunduar nga një pasha i fuqishëm, i cili prirrej të shkëputej nga pushteti qendror i sulltanit. Pashallëku i Shkodrës. Pashallëku i Janinës.

PASHË m. 1. shih PASHA, ~I.

2. Përdorej për nderim pas emrit të një njeriu, që kishte titullin e pashait. Ali Pashë Tepelena. Mustafa Pashë Bushati.

PASHTRAK m. 1. Kullotë brenda kufijve të një bajraku.

2. Taksë a gjobë që paguhej për shfrytëzimin e një kullote të huaj ose të një kullote të ndaluar; taksë kullote.

PASHTREF m. Pashtrak.

PATËRSHANË f. vjet. Heshtë, shtizë. Të armatosur me patërshana. Shkëlqenin patërshanat. Hodhi (vërviti) patërshanën.

PATRIARK m. 1. Kryetar i fisit në shoqërinë e bashkësive primitive; kryetar i familjeve të mëdha të dikurshme, që nderohej më shumë se të gjithë dhe që kishte të drejta të plota mbi anëtarët e tjerë të fisit. Patriarkët e fiseve (e familjeve të mëdha). Pushteti i patriarkut.

PATRIARKALIZËM m. 1. Sundim i plotë dhe i padiskutueshëm i burrit a i kryefamiljarit në familje ose në marrëdhëniet shoqërore gjatë patriarkatit. Mbeturina të patriarkalizmit.

PATRIARKAT m. Periudha e fundit e rendit shoqëror të komunës primitive pas matriarkatit, që karakterizohej nga sundimi i plotë i burrit në familje e në marrëdhëniet shoqërore. Periudha e patriarkatit. Kalimi nga matriarkati në patriarkat.

PATRIC m. Aristokrat në Romën e Vjetër; kund. plebe. Lufta midis plebenjve dhe patricëve.

PENDAR m. 1. Ai që lëron tokën me qe, ai që nget pendët në arë. Pendarët e kooperativës.

Punoi si pendar.

3. Çifçi.

PERS m. Persian.

PERS mb. Persian.

PERSIAN m. Banor vendas i Persisë ose ai që e kishte prejardhjen nga Persia.

PËRDREDHORE f. Mjet lufte, me të cilin hidheshin gurë, shigjeta etj. (sidomos gjatë sulmit kundër kështjellave). Qëllonte me përdredhore. Përdornin përdredhoret.

PËRKRENARE f. Mbulojë koke prej metali, si helmetë, me trajta të ndryshme, që përdorej nga luftëtarët në kohët e lashta dhe në mesjetë për t'u mbrojtur nga goditjet e armëve të armikut. Përkrenare ilire (romake).

PINJALL m. Armë e ftohtë si thikë e hollë, e mprehtë e me dy teha, shish. I nguli pinjallin.

E therin me pinjall.

PIRAMIDË f.

2. Ndërtesë e madhe me blloqe guri, me bazë katrore dhe me katër faqe anësore në trajtë trekëndëshi dybrinjënjëshëm e të bashkuara sipër në një kullm, që shërbente si varr për faraonët e Egjiptit të lashtë. Piramida e Keopsit.

PIRG m. 1. Ndërtesë e lartë rrumbullake a katërkëndëshe pranë mureve të një qyteti ose të një kështjelle, që shërbente për mbrojtje, si pikë vrojtimi etj.; kullë e lartë, zakonisht e rrumbullakët. Pirgjet e kalasë (e murit rrethues). U shemb një pirg.

PIRUST m. kryes. Pjesëtar i njërit prej fiseve kryesore ilire, që banonte në trevat e Malësisë së Lezhës, të Mirditës dhe të

Matit dhe që ishte i dëgjuar për shkrimtjen e bakrit e të hekurit. Fisi i pirustëve. Trojet e pirustëve. Armët (zbukurimet) e pirustëve.

PISQOLLË f. 1. Armë e vjetër me çark, që mbushej nga gryka dhe mbahej në brez; kobure. Pisqollë e larë në argjend. Pisqollë dygrykëshe (me dy tyta).

PLAK m. 1. Burrë i vjetër në moshë. Plak i moçëm (i lashtë) plak shumë i vjetër. Plak i mençur (me mend). Pleq e të rinj të gjithë, i madh e i vogël. Azili i pleqve (shtëpia e pleqve). Grupi (kori) i pleqve. Fjalë pleqsh fjalë e urtë. Ecën (rri, flet) si plak. Ia dëgjon fjalën plakut. U bëftë plak! ur. (kur lind një djalë).

4. Burrë, zakonisht kamës, që zgjidhte ngatërresat ndërmjet njerëzve, që vendoste për punët e fshatit etj. Plaku i katundit kryeplaku i fshatit. Pleqtë e fshatit anëtarët e pleqësisë së fshatit. Ranë ndër pleq e shtruan çështjen në pleqësinë e fshatit.

PLEBE m. 1. Njeri i shtresave të ulëta në Romën e Vjetër, që mund të ishte i lirë, por nuk gëzonte të drejta politike. Plebenjtë dhe patricët. Kryengritjet e plebenjve.

2. Njeri i shtresave të varfra në mesjetë; vegjelia.

PLEQËRI f. 1. Mosha e njeriut kur është plak, vitet në këtë moshë; të qenët plak, gjendja e dikujt kur është plak. Pleqëri e bardhë (e gëzuar). Pleqëri e shkuar moshë kur dikush është shumë plak. Pleqëri e parakohshme. Koha (vitet, ditët) e pleqërisë. Shenjë pleqërie. I afroi pleqëria. E kaloi pleqërinë në vendlindje. E zuri pleqëria u plak. Nuk punove në të ri, rri e qaj në pleqëri. 4. edhe ~, ~TË shih PLEQËSI, ~A 2. Pleqëritë e katundeve. Bëri pleqëri pleqëroi. Ndau pleqëri.

PLEQËSI f. 1. përmb. Këshill burrash, të zgjedhur në një fshat a në një lagje, që vendosnin për punët e fshatit a të lagjes, pajtonin gjaqet, zgjidhnin mosmarrëveshjet etj.; organ këshillues i pushtetit shtetëror

- në një krahinë që përbëhej prej njerëzve të parisë; kuvendi i pleqve. Pleqësia kombëtare. Pleqësia e fshatit. Pleqësia dhe vegjëlia.
- PORTË** f. Porta e Lartë sulltani dhe qeveria si autoriteti më i lartë e përfaqësues i Perandorisë Osmane.
- POSTËKOMANDANT** m. Komandanti i xhandarmërisë në një komunë.
- POSTËKOMANDË** f. Komanda e xhandarmërisë në një komunë; ndërtesa ku ishte vendosur kjo komandë. Postëkomanda e xhandarmërisë. Asgjësoi një postëkomandë.
- PRANGA** vet. 1. Zinxhir a hekura me hallka të kapura njëra me tjetrën, që përdoren për t'i lidhur duart dikujt që arrestohet a burgoset; zinxhir me hallka të forta, që përdorej nga skllavopronarët për t'u lidhur këmbët dhe duart skllavëve. I vunë prangat.
- PREFEKT** m. 1. Nëpunës i lartë qeveritar në një prefekturë, kryetari i prefekturës.
4. Titull për disa nëpunës të administratës dhe për disa ushtarakë; emërtim për disa nëpunësi në administratë dhe në ushtri (në Romën e lashtë).
- PREFEKTURË** f. 1. Njësia më e madhe e ndarjes administrative e tokësore në Shqipëri para Çlirimit, që kishte si qendër një qytet kryesor; organ i pushtetit shtetëror në një njësi të tillë; ndërtesa e zyrat e këtij organi shtetëror. Prefektura e Beratit (e Korçës). Qendra e prefekturës. Nëpunësit e prefekturës. E thirrën në prefekturë. Partizanët sulmuan dhe morën prefekturën.
2. Njësia më e madhe e ndarjes administrative e tokësore në disa vende borgjezë, që ka në krye një prefekt; organi i pushtetit shtetëror në një njësi të tillë; ndërtesa e zyrat e këtij organi shtetëror.
- PREHISTORI** f. Parahistori. Prehistoria e vendit. Ka kaluar në prehistori i përket së shkuarës së largët.
- PREHISTORIK** mb. Parahistorik. Kohët prehistorike. Kafshë (qenie) prehistorike. Vendbanim prehistorik. Kultura (piktura) prehistorike.
- PRIFT** I m. 1. Titulli fetar më i thjeshtë në kishën e krishterë; ai që mban këtë titull dhe kryen shërbesat e zakonshme fetare (në vendet ku vepron kisha e krishterë); ai që kryente shërbesat fetare në një tempull (në kohën e lashtë), faltar. Prifti katolik (ortodoks). Prift fshati. U bë (doli) prift. Ishte bërë si prift ishte pa rruar. Barku i priftit është hambar për të pirë e për të marrë.
- PRIFTËRESHË** f. 1. E shoqja e priftit.
2. Grua ose vajzë që kryente shërbesat fetare në një tempull (në botën e lashtë).
- PRINC** m. 2. Sundimtari i një principate (në shoqërinë feudale). Princ feudal vasal i një mbreti a perandori. Princat e Arbrit.
- PROLETAR** m. 1. Punëtor me mëditje në shoqërinë kapitaliste, i cili nuk ka asnjë mjet prodhimi, nuk zotëron asgjë tjetër përveç fuqisë së krahut, që është i detyruar t'ia shesë kapitalistit për të mos vdekur nga uria; pjesëtar i klasës së proletariatit. Proletarët e qytetit (e fshatit). Proletarë të të gjitha vendeve, bashkohuni!
2. Qytetar i shtresës më të varfër e më të ulët në Romën e Vjetër.
- PRONË** f.
3. Arat bashkë me shtëpinë; toka, çifligu.
- PUNË** f. Ndarja e punës. Ndarja e punëve në familje.
- PURITAN** m. 1. Ithtar e përkrahës i puritanizmit.
- QARKKOMANDANT** m. Komandanti i xhandarmërisë në një prefekturë. Vranë qarkkomandantin.
- QARKKOMANDË** f. Komanda e njërive të xhandarmërisë të një prefekturë; ndërtesa ku ishte vendosur kjo komandë. Qarkkomanda e xhandarmërisë.

QARKOR m. bised. Komiteti qarkor i Partisë Komuniste të Shqipërisë ose i Rinisë Komuniste të Shqipërisë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare dhe në vitet e para pas Çlirimit.

QENDROR m. 1. bised. Organi udhëheqës partiak. Udhëzimet e Qendrorit. Shokët e Qendrorit.

2. vjet. Organi qendror drejtues i një administrate.

QINDËS m. Komandant i një njësie ushtarake prej rreth njëqind vetësh. Urdhri i qindësit.

QINDËSHE f.

5. Njësi ushtarake prej njëqind vetësh ose më shumë, që vepronte me një rreshtim të caktuar. Qindëshet e zeza banda të armatosura vrasësish, të organizuara në Rusi nga policia cariste dhe nga partitë monarkiste për të goditur forcat revolucionare; reaksionarët me të tërbuar. Qindëshet romake centuriet. Qindëshet kozake (turke). Qindëshja e rojës. Komandanti i qindëshes.

QYTET-SHTET m.

Qytet së bashku me krahinën përreth në periudhën e skllavopronarisë (kryesisht në Greqinë e lashtë), i cili kishte një formë të veçantë organizimi politik e shoqëror, që u siguronte qytetarëve të lirë kushtet për të shtypur e shfrytëzuar skllavërit. Qytet-shtet skllavopronar.

RAJA f. 1. Nënshjetas jo mysliman në Perandorinë Osmane, që nuk kishte të drejta e shtypej egërsisht.

REND II m.

4. Shtresë shoqërore në periudhën e feudalizmit, e cila kishte të drejta e detyra të trashëgueshme, që pasqyronin marrëdhëniet klasore dhe luftën e klasave në këtë periudhë. Rendet e privileguara aristokracia dhe kleri. Rendet e shtypura (e ulëta). Rendi i tregtarëve. Ndarja e popullsisë në rende. Zhdukja e rendeve.

RI mb. Turqit e rinj. xhonturqit.

RILINDËS m. 1. Ideolog, veprimtar dhe luftëtar i Rilindjes Kombëtare Shqiptare, përfaqësues i Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Rilindës i shquar. Rilindësit tanë. Shkrimet (veprat) e rilindësve. Gjuha e rilindësve. Dëshirat (përpyjekjet, ëndrrat) e rilindësve. Në gjurmët e rilindësve. 2. Përfaqësues i Rilindjes evropiane.

RILINDJE f.

2. Epoka e lulëzimit të shkencave dhe të arteve në disa vende të Evropës në shekujt XV e XVI, që lidhej me lindjen e me zhvillimin e borgjezisë e të marrëdhënieve kapitaliste dhe që iu kundërvu ideologjisë e kulturës mesjetare, duke iu drejtuar si mbështetje kulturës dhe artit të lashtësisë. Rilindja evropiane. Letërsia (kultura) e Rilindjes. Poetët e Rilindjes. Arti i Rilindjes. Përfaqësuesit e Rilindjes. Epoka (lëvizja) e Rilindjes.

3. Lëvizje e gjerë politike, shoqërore e kulturore me karakter kombëtar, demokratik e revolucionar, që mori hov në Shqipëri që nga gjysma e parë e shekullit XIX e vazhdoi deri në Shpalljen e Pavarësisë dhe që luftoi me armë e me penë për çlirimin e vendit nga pushtuesit e huaj, për krijimin e shtetit kombëtar të pavarur, për kapërcimin e mbeturinave të theksuara të rendit feudal e për përhapjen e zhvillimin e arsimit e të kulturës në gjuhën amtare. Rilindja Kombëtare Shqiptare. Epoka e Rilindjes. Ideolog (shkrimtar, poet, mendimtar) i Rilindjes. Letërsia e Rilindjes. Shtypi i Rilindjes.

ROB m. 1. Ai që nuk kishte fare mjete prodhimi, që nuk kishte asnjë të drejtë dhe që ishte pronë e plotë e një pronari, i cili e detyronte të punonte në kushte shumë të rënda e mund ta shiste a ta vriste. Skllavopronarët dhe robërit. Kryengritjet e robërve. Tregtia (shitja, blerja, vrasja) e robërve. Shitej (blihej si rob).

2. Skllavi i tokës, bujkrob. Robërit e tokës. Bujq robër.

ROBËRI f. 1. Gjendja e atij që ka humbur lirinë; të qenët nën zgjedhën e dikujt, skllavëri. Robëria fashiste (osmane).

- Theu prangat (zinxhirët) e robërisë. Ra në robëri.
- U çliruar (shpëtuar) nga robëria.
2. Bujkrobëri. Robëria feudale.
- ROMAK** m. Qytetar i Romës së lashtë ose i Perandorisë së lashtë të Romës. Legjionet e romakëve.
- ROMAK** mb. Që lidhet me Perandorinë e lashtë të Romës ose me qytetarët e saj, që është karakteristik për Perandorinë e lashtë të Romës ose për qytetarët e saj, i Romës ose i romakëve të lashtësisë; që është krijuar nga romakët e lashtë. Perandoria Romake. Bota romake. Pushimet romake. E drejta romake. Arti romak. Sundimi romak.
- RRETHKOMANDANT** m. Komandant i xhandarmërisë në një nënprefekturë. Rrethkomandanti varej nga qarkkomandanti.
- RRETHKOMANDË** f. Komanda e njërive të xhandarmërisë të një nënprefekturë; ndërtesa ku ishte kjo komandë.
- SANXHAK** m. Njësi administrative në kohën e Perandorisë Osmane, me shtrirje tokësore të ndryshme sipas periudhave historike dhe me një sanxhakbej a me një mytesarif në krye. Sanxhaku i Dibrës (i Beratit).
- SANXHAKBEJ** m. Komandant ushtarak dhe qeveritar i një sanxhaku. Sanxhakbeu i Elbasanit (i Shkodrës). Ekspeditat e sanxhakbejlerëve turq.
- SATRAPLAK** m. Stërplak.
- SEKSION** m. Seksioni politik. organ i divizionit (më parë i brigadave) në Ushtrinë Nacionalçlirimtare, që drejtonte e zhvillonte punën politike dhe edukuese.
- SENAT** m. 1. Organi më i lartë i pushtetit shtetëror në Romën e lashtë të skllavopronarëve; kuvend i lartë shtetëror në disa republika të kohës së lashtë ose të mesjetës. Senati i Romës. Senati i Spartës. Senati i Venedikut (i Raguzës).
3. Organ i lartë qeveritar në Rusi para revolucionit, që bënte punën e gjyqit të lartë dhe mbikëqyrte veprimtarinë e organeve të tjera qeveritare.
- SEPARATIZËM** m. Separatizëm feudal. përpjekjet e feudalëve për të mos iu nënshtruar pushtetit qendror të mbretit.
- SERASQER** m. Kryekomandant në ushtrinë turke. Serasqeri i Rumelisë (i Moresë). Serasqeri i taborëve ndëshkimore.
- SERDAR** m. Komandant i një reparti të madh në ushtrinë turke në kohën e Perandorisë Osmane. Serdari i jeniçerëve. Serdarët e taborëve.
- SKIT** m. kryes. Pjesëtar i fiseve shtegtare, që banonin në brigjet veriore të Detit të Zi rreth shekullit të 7-të para erës së re e deri në shekullin e 3-të të erës së re. Fiset e skitëve. Gjuha (zakonet) e skitëve.
- SKLLAV** m. 1. Njeri pa asnjë mjet prodhimi dhe pa asnjë të drejtë, që ishte pronë e plotë e një pronari, i cili mund ta shiste e ta blinte dhe mund të bënte ç'të donte me jetën e tij (në shoqërinë skllavopronare). Skllavopronarët dhe skllavërit. Kryengritjet e skllavëve. Pronarët e skllavëve. Punonin si skllavë.
- SKLLAVËRI** f.
3. Rendi shoqëror që mbështetej në pronën e skllavëve, skllavopronaria. Periudha e skllavërisë. Përmbysja e skllavërisë. Mbeturinat e skllavërisë në shoqërinë kapitaliste.
- SKLLAVOPRONAR** m. Përfaqësuesi i klasës sunduese në sistemin shoqëror që mbështetej në shfrytëzimin e punës së skllavëve; ai që zotëronte skllavë, pronar skllavërisht. Skllavopronarët romakë (grekë). Skllavopronarët e shteteve jugore të Amerikës. Shteti i lashtë i skllavopronarëve. Ndarja e parë e madhe me klasa në skllavopronarë dhe në skllavë.
- SOCIAL** mb.
- * Asistenca sociale organizëm i ngritur në vitet fill pas Çlirimit për të ndihmuar të

dëmtuarit nga lufta dhe shtresat e varfra. Ushqimi social shih tek USHQIM, ~I.

SOFIST m. 1. Emërtim i një grupi dije-tarësh në Greqinë e lashtë, mësues të filozofisë e të gojëtarisë, që dalloheshin për arsyetimet e holla, të mbështetura në logjikën formale, por që më pas braktisën çdo parim dhe përpiqeshin me mënyra të rreme të mbronin ose të rrëzonin njësoj si të vërtetën e të drejtën, ashtu edhe të shtrembrën. Sofistët grekë të shekujve IV-V para erës së re.

SOVJET m. Këshilli i të dërguarve të punëtorëve, të fshatarëve dhe të ushtarëve në Rusi gjatë dhe pas Revolucionit të Shkurtit 1917; organ i zgjedhur i pushtetit shtetëror në Bashkimin Sovjetik. Sovjeti i fshatit (i qytetit). Sovjetët e punëtorëve (e fshatarëve, e ushtarëve) gjatë Revolucionit të Tetorit. Gjithë pushtetin sovjetëve!

SPAHI m. Feudal në Perandorinë Osmane, të cilit i jepej një pronë (timar) dhe e drejta për të vjelë detyrimet nga bujqit, me kusht që të shkonte në luftë si kalorës me një numër të caktuar ushtarësh. Timari i spahiut. Ushtria e spahinjve. Fshatarët vuanin nga bejlerët, pashallarët e spahinj-të. I pinte të gjallë spahiu.

SPAHILLËK m. 1. Shërbimi spahiut dhe të drejtat e tij; sistemi i sundimit të spahinj-ve. E drejta e spahillëkut. Heqja e sistemit të spahillëkut.

2. Të ardhurat që nxirrte spahiu duke u marrë të dhjetën fshatarëve; e dhjeta dhe taksa të tjera që u merreshin me detyrim fshatarëve nga bejlerët. U kërkonin spahillëkun. Bejlerëve iu prenë spahillëqet.

3. Prona e tokës (timari), mbi të cilin ushtronte të drejtat e tij një spahi. Të ardhurat nga një spahillëk.

SPARTAN m. Banor i lirë i qytetit-shtet skllavopronar të Spartës në Greqinë e lashtë, qytetarët e të cilit stërviteshin me disiplinë të rreptë për të duruar kushte të vështira jetese. Luftërat e spartanëve

kundër athinasve. Jetë spartani. Qëndruan si spartanë.

SPARTAN mb. 1. Që lidhej me Spartën e lashtë ose me spartanët; që ishte karakteristik për Spartën ose për spartanët, i Spartës ose i spartanëve, që është krijuar nga spartanët. Ushtria spartane. Anijet spartane.

STËRPLAK m. Plak i dytë që thirrej nga pleqtë e caktuar prej kanunit të malësive për t'i ndihmuar ata që të hetonin e të zgjidhnin një çështje sipas së drejtës zakonore.

STRATEG m. 1. Ushtarak specialist në fushën e strategjisë; komandant që drejton veprime të gjera luftarake të njësive të mëdha ushtarake. Strateg ushtarak. Strateg i shquar.

4. Komandant epror me fuqi ushtarake dhe civile (në Greqinë e lashtë dhe në Perandorinë Bizantine).

STREHORE f. Mbulesë e gjerë prej thuprash, që e mbanin përpara luftëtarët në kohët e vjetra për t'u mbrojtur nga shigjetat dhe nga gurët në betejë.

SUNDIMTAR m.

2. Zyrtar i lartë, i plotfuqishëm, që përfaqësonte pushtetin qendror në një krahinë; ai që kishte fuqinë në dorë në një krahinë.

SHATËR m. Djalë nga një familje fisnike, që shërbente në oborrin e një princi a të një mbreti (në sistemin feudal); shërbëtor shtëpie. E mori (shërbeu) si shatër. Vajti i rrethuar nga shatrit.

SHIGJETAR m. 1. Ushtar këmbësor ose kalorës i armatosur me shigjeta e me hark, harkëtar. Grupi i shigjetarëve.

SHKATËRRUES mb. Shkatërruesit e makinave. Shkatërruesit e së vjetrës.

SHPATAR m. Luftëtar që luftonte me shpatë.

SHPATËMBAJTËS m. Shërbëtori që i mbante shpatën një kalorësi në mesjetë.

SHPATULLORE f.

2. Pjesë e armorit që mbronte supin. Hoqi shpatulloren.

SHQYT m.

2. Pjesa kryesore e stemës së një familjeje feudale, të një qyteti etj., e përbërë nga një fushë me figura të ndryshme.

SHQYTAR m. 1. Trim i ri që shoqëronte kalorësin në mesjetë dhe i mbante shqytin e armët.

2. Titull i ulët fisnikërie.

SHTIZAR m. Luftëtar i armatosur me shtizë, kalorës që luftonte me shtizë, heshtar. Sulmi i shtizave.

SHTIZË f. 1. Heshtë. Plagë shtize. Luftonin me shtizë.

SHTIZËMBAJTËS m. Shtizar, heshtar.

SHTIZOJ kal. 1. Shpoj me shtizë, luftoj e vras me shtizë.

SHTIZOR m. Shtizar, heshtar.

SHULK m. Shkarth.

TABOR m. 1. Njësi ushtarake me një mijë veta në ushtrinë e dikurshme osmane; batalion. Taborë kalorësish. Taborët e kryengritësve.

TAGËR m. vjet. 1. E drejtë që ka një njeri për diçka. Tagër i plotë. Jashtë tagrit të tij. Njeri pa tagër. Ishte në tagrin e dikujt. S'kishte tagër. I dha tagër.

2. Çdo taksë a tatim që i paguhej shtetit. Tagër i lartë (i paligjshëm). Tagra të rënda. Tagër doganor. Të ardhura nga tagrat. Paganin (shlyenin) tagrat.

TAGRAMBLEDHËS m. Nëpunës që mbledhte taksat ose tatimet, mbledhësi i tagrave. E përzunë tagrambledhësin. Ç'më vjen si tagrambledhës? keq.

TAGRAPAGUES m. Ai që paguante taksa ose tatime, ai që shlyente tagrat. Tagrapaguesit e varfër. Rëndonin mbi tagrapaguesit.

TARTAR m.

2. Pjesëtar i fiseve turke, mongole etj. që formonin shtetin «Hordhia e Artë» në shekujt XIII-XV.

3. vjet. Kalorës që kryente shërbimin postar në kohën e pushtimit osman.

TAULANT m. Pjesëtar i njërit prej fiseve kryesore ilire, që banonte në trojet bregdetare midis lumenjve Mat e Vjosë. Fisi i taulanteve. Shteti i taulantëve.

TAULANT mb. Që ka të bëjë me taulantët, që është krijuar nga taulantët; që u përket taulantëve, i taulantëve. Shteti taulant. Ushtria taulante.

TELOZNË f. zakon. Haraç.

TEMPULLAR m. Kalorës a fisnik i një urdhri katolik në mesjetë.

Anëtar i urdhrit të tempullarëve.

TESPROT m. kryes. Pjesëtar i njërit prej fiseve ilire, që banonte në krahinën e Çamërisë së sotme.

Fisi i tesprotëve.

TESHË f.

5. vet. Enë balte a sende të tjera, që i viheshin të vdekurit të varr.

TIMAR m. Tokë a vend me madhësi të ndryshme, me të ardhura vjetore deri njëzet mijë akçe në vit, që u jepej në zotërim feudalëve spahinj, sipas shërbimeve që ata i sillnin Perandorisë Osmane. Sistemi i timareve.

TIRAN m. 1. Sundimtar i vetëm e me pushtet absolut në Greqinë e vjetër ose në Itali gjatë shekujve XIII-XVI, i cili vinte në fuqi me dhunë.

TITULL m. 1. Emër nderi, që mbanin pronarët e mëdhenj feudalë; sipas pronës a fisit. Titull i trashëgueshëm. Titulli baron (kont, dukë, markez).

TOGË f. Tufëz ose xhufkë me qime nga bishti i kalit, që e mbanin pashallarët si shenjë dalluese të gradës së tyre. Pasha me tri tuga.

- TOGË** II f. 1. Veshje sipërme e gjatë, zakonisht e bardhë, që mbanin qytetarët; zyrtarët lartë e priftërinjtë në Romën e lashtë. Togë me shirit të qëndisur.
- TOPJAK** m. Taksë që paguhej për kullotjen e bagëtive në kohën e pushtimit osman dhe regjimeve të kaluara. U kërkoni (u merrnin) topjakun.
- TOTEMIZËM** m. mit. 1. Formë e lashtë e fesë në rendin fisnor, kur adhurohej si diçka e shenjtë një kafshë, një bimë, ndonjëherë edhe një send, që quhej edhe si themelues e si mbrojtës i fisit.
2. Organizim shoqëror, në rendin fisnor që bazohej në totemet dhe në adhurimin e tyre.
- TRAK** m. Pjesëtar i popullsisë së vjetër të Trakisë, banor i Trakisë.
- TRAK** mb. Që lidhet me Trakinë ose me trakët, që është karakteristik për Trakinë ose për trakët, i Trakisë ose i trakëve; që është krijuar nga trakët. Shteti trak. Fis trak. Gjuha trake. Veshje trake. Varre trake. Kultura trake. Grua trake. Mbishkrime trake.
- TRAKAS** m. Trak.
- TRAKAS** mb. Trak.
- TRETAR** I m. 1. Ai që i merrte pronarit për përdorim tokën a bagëtinë dhe i jepte një të tretën e prodhimit.
2. Ai që mblidhte të tretën, ai që merrte të tretën.
- TRETË** f. 1. Një e treta e prodhimit; që ishte i detyruar t'i jepte bujku pronarit të tokës a të bagëtisë. Të tretat e të dhjetat. Paganin të tretën. Mblidhte të tretat.
- TRIBUN** m.
2. Titull që mbanin disa funksionarë zyrtarë me detyra të ndryshme civile ushtarake në Romën e lashtë. Tribun i plebenjve mbrojtës i të drejtave të plebenjve, të cilët shtypeshin nga patriotët dhe nga konsujt. Tribun ushtarak.
- TRIUMVIRAT** m. 1. Grup prej tre vetash në Romën e lashtë, që drejtonin së bashku shtetin; koha sa zgjaste pushteti i tyre. Triumvirati i parë (i dytë).
2. Grup prej tre vetash që drejtojnë shtetin ose kryejnë një veprimtari të përbashkët.
- TROGLODIT** m. 1. Banor i lashtë i Afrikës, i Azisë etj., që jetonte nëpër shpella; njeriu primitiv i kohës së gurit.
- TRUPARMATË** f. usht. 1. Njësi e madhe ushtarake që përbëhet nga dy-tre divizione dhe nga trupa speciale; korparmatë.
2. shih KORPARMAT/Ë, ~A.
- TUJË** f. Tugë. Një pasha me shtatë tuja.
- TUNIKË** f. 1. Veshje e brendshme a e jashtme prej leshi a prej liri, zakonisht e bardhë, si këmishë, me mëngë dhe e gjatë deri te gjunjët, që e mbanin romakët e vjetër. Tunikë e bardhë. Tunikë e leshtë. Tunikë burrash (grash).
- TURRË** II f.
2. Vula e sulltanëve në shkresat e në paratë e Perandorisë Osmane.
- TYM** m.
3. Tymjake.
- TYMJAKE** f. Taksë që paguhej në kohën e pushtimit osman për çdo shtëpi a oxhak. Paganin tymjaken. Mblidhte tymjaket.
- THURAK** m. Këmishë e gjatë, e thurur si rrjetë me rripa a me fije të trasha prej metali, që e vishnin luftëtarët në kohë të vjetra për t'u mbrojtur nga armët e ftohta; parzmore e thurur. Pëqiri i thurakut pjesa e thurakut që mbronte pëqinë dhe kofshët.
- UPRI** f. 1. Grup fshatarësh që shkonin për të ndihmuar falas në punët bujqësore ndonjërin prej bashkëfshatarëve të tyre. Shkonte upria. E ndihmoi (e shpëtoi) upria. Kishte uprinë atë ditë. I kishte ardhur upria.
2. Ndihma që i jepte ky grup fshatarësh një tjetri.

URDHËR II m.

2. Bashkësi ushtarako-fetare në mesjetë, e krijuar nga shtetet feudale e nga papa për qëllime pushtuese e grabitqare. Urdhri teuton. Urdhri i kryqtarëve.

VAKËF m. 1. Pasuri e patundshme, që ishte pronë e një xhamie, e një kishe, e një teqeje a e një manastiri.

VALI m. Qeveritari më i lartë, i emëruar nga sulltani, në një vilajet të Perandorisë Osmane.

VANDAL m. 1. Pjesëtar i një popullsie të hershme gjermanike, e cila në shekullin V u dynd nga brigjet e lumit Oder, pushtoi një pjesë të Perandorisë Romake, plaçkiti Romën dhe shkatërroi shumë monumente të artit e të kulturës. Shteti i vandalëve. Sulmet e vandalëve.

VASAL m. sh 1. Feudal që i nënshtrohej një feudalit tjetër më të madh, një princi ose një mbreti.

VENEDIKAS m. Banor i Venedikut ose ai që e kishte prejardhjen nga Venediku.

VENEDIKAS mb. Që lidhet me Venedikun ose me venedikasit, që është karakteristik për Venedikun ose për venedikasit, i Venedikut ose i venedikasve; që është krijuar nga venedikasit. Historian venedikas. Tregtar venedikas. Kultura venedikase. Ushtria (flota) venedikase. Stil venedikas.

VENOM m. 1. E drejtë zakonore e pashkuar, që vepronte në një krahinë a në disa krahina dhe ruhej e zbatohet nga të gjithë; përmbledhje a tërësi rregullash, normash e zakonesh të pashkuara, që ruheshin e zbatoheshin nga të gjithë, kanun. Vendosën një venom.

2. E drejtë e veçantë që gëzonte dikush sipas kanunit.

VERGJI f. Taksa që paguhej për banesën, për dyqanin etj. Vergji e rëndë. Paganin vergjinë.

VEZIR m. Nëpunësi më i lartë qeveritar në Perandorinë Osmane dhe në disa vende të Lindjes së Afërt; titull i pashallarëve vendës që kanë sunduar në Shkodër dhe në Janinë në shekujt XVIII e XIX. Veziri i madh kryeministri i ish-perandorisë turke. Veziri i Shkodrës (i Janinës).

VILAJET m. Ndarje e madhe administrative në Perandorinë Osmane, që kishte në krye një vali. Qendra e vilajetit. Ndarje në vilajete.

VILË I f. 1. Shtëpi e bukur e rrethuar zakonisht me kopsht dhe e pajisur mirë; shtëpi e tillë jashtë qytetit për të pushuar gjatë verës. Vilë dykatëshe. Vilat e plazhit. Banonte në vilë.

2. Çifligu i skllavopronarit në Romën e Vjetër.

VOJVODË m. 1. I ngarkuar i qeverisë osmane për një krahinë të caktuar në Shqipërinë e Veriut në shekullin XIX, i cili ndiqte zbatimin e urdhrave të qeverisë sidomos pas reformës së Tanzimatit; detyra e këtij të ngarkuari. I dëbuan vojvodët.

XHELEP m. Tatim që paguhej për bagëtinë në kohën e pushtimit osman dhe të regjimeve të kaluara. Paganin xhelepin. U kërkonin (u merrnin) xhelepin.

XHELEPÇI m. Ai që mbledhte xhelepin. Vinin xhelepçinjtë. I dëbuan xhelepçinjtë.

XHONTURK mb. Që ka të bëjë me xhonturqit; që bëhet nga xhonturqit ose që drejtohet prej tyre, i xhonturqve. Qeveria xhonturke. Lëvizja xhonturke. Rrëgjimi xhonturk.

Propaganda xhonturke.

YSHYR m. 1. Taksë a e dhjetë në natyrë që u merrej bujqve gjatë sundimit osman.

Yshyri i tokës. Jepnin yshyrin.

ZAKON m. 1. Mënyrë veprimi, sjelljeje etj., që është ndjekur e është përsëritur vazhdimisht nga dikush; shprehje e fituar nga përsëritja e vijueshme e një veprimi, e cila ruhet për një kohë të gjatë. Zakon

i mirë (i keq, i dëmshëm). Sipas zakonit si zakonisht. E ka (e bëri) zakon. E preu (e hoqi) atë zakon.

2. Rregull a normë në mënyrën e jetesës (në sjelljen, në veshjen, në marrëdhëniet shoqërore etj.), që është vendosur historikisht e zbatohet si ligj i pashkruar nga një popull, nga një fis, nga një klasë a shtresë shoqërore etj. dhe që trashëgohet brez pas brezi; vet. doke. Zakone të reja (përparimtare, socialiste). Zakone të vjetra (të dëmshme, konservatore,

prapanike). Zakone fisnore (patriarkale, kanunore). Zakonet e vendit. Zakonet e dasmës (e lindjes, e vdekjes). Burrë (plak) zakoni burrë (plak) që ndjek zakonet e vjetra. Forca e zakonit. Doke e zakone. Thyen (shkel, prish, zhduk) zakonet. Si e do (si është) zakoni. Nuk e kanë zakon.

3. Kanun. Sipas zakonit.

ZHAVELLË I f. Lloj shtize jo shumë e gjatë. Qëllonin me zhavella.